



MATRICA E MONITORIMIT MBI MJEDISIN MUNDËSUES PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE



BALKAN
CIVIL
SOCIETY
DEVELOPMENT
NETWORK


Në partneritet me



Paketa shpjeguese



Publikuar në shqip nga Partnerët Shqipëri,
Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti.



BALKAN
CIVIL
SOCIETY
DEVELOPMENT
NETWORK

Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Paketa shpjeguese



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



Përgatitja e këtij botimi u mundësua nëpërmjet mbështetjes bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e tij është përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID apo të qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Përkthimi dhe botimi në shqip i këtij materiali u bë i mundur nëpërmjet mbështetjes së Qendrës Olof Palme International në Shqipëri, me fonde të qeverisë Suedeze. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës Olof Palme International apo qeverisë Suedeze.

© 2013 Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Qendra Evropiane për Ligjin Jo-fitimprurës dhe Qendra Ndërkombëtare për Ligjin Jo-fitimprurës. Të gjitha të drejtat e rezervuara.
Kopjet e versionit në anglisht të këtij publikimi mund të porositen me postë ose email si më poshtë:
Balkan Civil Society Development Network (BCSDN)
Rruga Bel Kamen nr. 6/8, 1000 Shkup, Maqedoni
Email: executiveoffice@balkancsd.net
<http://www.balkancsd.net>

Redaktorë: Tanja Hafner Ademi, Katerina Hadzi- Miceva Evans

Ekspertë: Juliana Hoxha (Partnerët Shqipëri), Slavisa Prorok (CPCD), Luben Panov (BCNL), Vanja Skoric dhe Nives Miosic Lisjak (GONG), Taulant Hoxha (KCSF), Emina Nuredinoska (MCIC), Ana Novakovic (CRNVO), Miljenko Dereta dhe Maja Stojanovic (Iniciativa Qytetare, Serbi), Tina Divjak (CNVOS) dhe Başak Ersen (TUSEV).

Publikuar në shqip nga Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti.

Për kopje në gjuhën shqipe kontaktoni me zyrën e Partnerëve Shqipëri si më poshtë:

Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti.

Rruga Sulejman Delvina, N.18, H.8, Ap. 12, Njësia Bashkiake 5,

Kodi Postar 1022, Tiranë, Shqipëri,

Kutia Postare (PO Box) 2418/1

Tel. 04 2254881 Fax: 04 2254883

Email: partners@partnersalbania.org

<http://www.partnersalbania.org>

Dizajni dhe faqosja: DFS Studio

Shtypur në: GentGrafik

Botuar në Shqipëri, Shtator 2013

Përmbajtja

| | |
|---|-----------|
| Shkurtime | 3 |
| Mirënjohje | 5 |
| Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile | 7 |
| Fusha 1: Garancitë themelore juridike të lirive | 9 |
| Fusha 2 : Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OJF-të. | 25 |
| Fusha 3: Marrëdhënia Qeveri-OSHC | 39 |
| Si të përdoret Matrica | 56 |
| Aneks - Matrica | 60 |
| Referenca | 69 |

Shkurtime

| | |
|--------------|--|
| BCSDN | Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile / Balkan Civil Society Development Network |
| OSHC | Organizatë e Shoqërisë Civile |
| BE | Bashkimi Evropian |
| KE | Komisioni Evropian |
| ECHR | Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms) |
| ECNL | Qendra Evropiane për Ligjin Jo-fitimprurës (European Center for Not-for-Profit Law) |
| ICCPR | Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (International Covenant of Civil and Political Rights) |
| ICNL | Qendra Ndërkombëtare për Ligjin Jo-fitimprurës (International Center for Not-for-Profit Law) |
| TIK | Teknologjia e Internetit dhe Komunikimit |
| IPA | Instrumenti i Asistencës së Paraaderimit (Instrument for Pre-accession Assistance) |
| LGBT | Komuniteti i lezbikeve, gejve, biseksualëve, transeksualëve |
| NED | National Endowment for Democracy |
| OJQ | Organizatë Jo-qeveritare |
| ODIHR | Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (Office for Democratic Institutions and Human Rights) |
| OSCE | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (Organization for Security and Cooperation in Europe) |
| UN | Kombet e bashkuara (United Nations) |

Mirënjohje

Zhvillimi i Matricës ka qënë përpjekja më emocionuese dhe në të njëjtën kohë më sfiduese që Rrjeti i Zhvillimit të Shoqërisë Civile në Ballkan (BCSDN) ka ndërmarrë që prej themelimit të tij në vitin 2001. Jemi po aq krenarë për punën e përbashkët të bërë nga anëtarët dhe partnerët e BCSDN-së sa edhe të motivuar për të vënë Matricën nën shqyrtimin e kolegëve të OSHC-ve dhe aktorëve të tjerë. Përmes këtij shqyrtimi dhe rishikimeve të ardhshme pas një viti periudhë "prove", shpresa jonë është që t'i përgjigjemi realisht dhe të përqafojmë nevojën e OSHC-ve për të udhëhequr ndryshime pozitive dhe zhvillimin e mjedisit në të cilin ato veprojnë. Një ndryshim dhe zhvillim i tillë do t'u lejojë atyre të kontribuojnë plotësisht në komunitetet e tyre për krijimin e ndryshimeve shoqërore pozitive.

Zhvillimi i Matricës monitoruese të mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile u bë i mundur si pjesë e përpjekjeve të përbashkëta të ekspertëve dhe praktikantëve të OSHC-ve nga rrjeti i partnerëve dhe anëtarëve të BCSDN-së. Ekipi prej 11 ekspertësh përfshiu një gamë të gjerë njohurish dhe eksperiencash specifike mbi OSHC-të dhe organizatat jofitimprurëse, si në aspektin ligjor ashtu edhe atë praktik, me përfaqësi nga 10 vende të Ballkanit. Kjo bëri të mundur që Matrica të marrë në konsideratë dhe të përfshijë ndryshimet specifike të këtyre vendeve. U organizuan pesë takime pune me ekspertët në një periudhë 8 mujore gjatë vitit 2012, e kombinuar me shkëmbime të rregullta mesazhesh emaili dhe në Skype për të mundësuar përcaktimin për herë të parë në mënyrë koherente dhe të unifikuar të çështjes komplekse lidhur me mjedisin mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile. Ekspertët e përfshirë në zhvillimin e Matricës janë: Juliana Hoxha (Partnerët Shqipëri, Shqipëri), Slavisa Prorok (CPCD, BiH), Luben Panov (BCNL, Bullgari), Vanja Skoric dhe Nives Miosic Lisjak (GONG, Kroaci), Taulant Hoxha (KCSF, Kosovë), Emina Nuredinoska (MCIC, Maqedoni), Ana Novakovic (CRNVO, Mal i Zi), Miljenko Dereta dhe Maja Stojanovic (Iniciativa Qytetare, Serbi), Tina Divjak (CNVOS, Slloveni) dhe Başak Ersen (TUSEV, Turqi). Paketa shpjeguese u realizua me mbështetjen e Luben Panov (BCNL, Bullgari) dhe Katerina Hadzi-Miceva Evans (ECNL).

Matrica tashmë i është nënshtruar shqyrtimit nga disa target-grupe. Në versionin e saj

fillestar, Matrica u prezantua dhe u diskutua në eventin për diskutimin e politikave organizuar në Bruksel në 30 Maj 2012 me aktorë të nivelit Evropian, duke përfshirë Komisionin Evropian, Departamentin e Përgjithshëm të Zgjerimit në Komisionin Evropian, Parlamentin Evropian dhe Komitetin Ekonomik e Social Evropian (EESC). Në 26 shtator 2012, u mbajt një takim i veçantë fokus grupi me përfaqësues të Agjencive Qeveritare përgjegjëse për bashkëpunimin dhe zhvillimin e shoqërisë civile në vendet e IPA. Ky grup kishte për detyrë të testonte Matricën ndaj pritshmërive dhe kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse përpara se ajo t'i nënshtrohej shqyrtimit të monitorimit real. Në fund, Matrica në versionin e saj final iu nënshtrua konsultimit publik në nëntor 2012.

Vlerësim i veçantë shkon për ekipin e IPA të Shoqërisë Civile në Departamentin e Përgjithshëm të Zgjerimit në Komisionin Evropian, të cilët ofruan kontribut të paçmuar lidhur me Matricën, dhe kanë treguar interes në përdorimin e saj për monitorimin e etapave të progresit të vendeve, në mbështetjen për shoqërisë civile nën mekanizmin IPA. Zyra e Qeverisë Kroate për Bashkëpunimin me OJQ-të, e drejtuar nga Igor Vidacak, dhe Zyra e Qeverisë Serbe për Bashkëpunimin me OJQ-të, e drejtuar nga Ivana Cirkovic, vlerësohen për mbështetjen e idesë fillestare, dhe për ofrimin e opinionëve dhe komenteve kundrejt realitetit me të cilin përballen Qeveritë, në mënyrë të tillë që Matrica të mund të kishte një impakt të vërtetë, konkret por edhe realist në punën e këtyrë institucioneve që lehtësojnë komunikimin e qeverisë me shoqërinë civile. Ne do të donim të falenderonim Lorenzo Fioramanti, Profesor i Asociuar në Shkencat Politike në Universitetin e Pretorias (Afrika e Jugut) dhe Senior fellow në Qendrën e Investimit Social të Universitetit Heidelberg dhe në Shkollën e Qeverisjes Hertie (Gjermani), për ndihmesën e tij në ngritjen dhe adresimin e çështjeve të metodologjisë në zhvillimin e Matricës. Do donim të falenderonim Ben Evans (Greenacre, Angli) për ofrimin e ekspertizës së tij në rishikimin e Matricës dhe Paketës shpjeguese.

Vlerësimi dhe falenderimi më i madh shkon për ekipin e Qendrës Ndërkombëtare për Ligjin Jofitimprurës (ICNL) dhe Qendrës Evropiane për Ligjin Jofitimprurës (ECNL) për bashkëpunimin, mbështetjen dhe ekspertizën e tyre strategjike, e cila ndihmoi në orientimin e ekipit të ekspertëve përmes çështjeve metodologjike dhe tematike, si dhe në ofrimin e një

perspektive më të gjerë ndërkombëtare e ligjore në mënyrë që Matrica dhe Paketa shpjeguese të mund t'i shërbejnë edhe komuniteteve të shoqërisë civile jashtë Ballkanit. Katerina Hadzi-Miceva Evans dhe Nilda Bullain marrin vlerësimin më të madh për ofrimin e ekspertizës konkrete në zhvillimin dhe rishikimin e Matricës dhe Paketës shpjeguese.

Së fundi, do donim të falenderonim USAID, Pact. Inc, dhe ICNL për mbështetjen e tyre mbi procesin e përgjithshëm të ekspertizës, seminareve dhe publikimit të kësaj Pakete shpjeguese e cila u ofrua nën Programin e Zhvillimit të Mjedisit Ligjor (LEEP)/Grantit të Inovacionit Ligjor. Gjithashtu falenderojmë Balkan Trust for Democracy (BTD) i cili mbështeti financiarisht një pjesë të punës së ekspertëve.

Tanja Hafner Ademi
Drejtore Ekzekutive
BCSDN

Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Matrica monitoruese prezanton parimet dhe standartet kryesore ekzistenca e të cilave është identifikuar si kryesore në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet si mbështetës dhe mundësues për veprimtarinë e OSHC-ve. Ajo nënvijëzon faktin që mjedisi mundësues është një koncept kompleks, i cili përfshin fusha të ndryshme dhe varet nga disa faktorë dhe faza të zhvillimit të shoqërisë dhe sektorit të shoqërisë civile.

Kjo Matricë nuk synon të përqafojë të gjitha çështjet e mjedisit mundësues, por ato që ekspertët kanë gjetur të jenë më të rëndësishmet për vendet në të cilat ata punojnë. Për këtë arsye, standartet dhe indikatorët janë formuluar duke marrë në konsideratë gjëndjen aktuale të zhvillimit dhe diversitetit në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Ato kanë dalë nga eksperiencat e OSHC-ve në këto vende lidhur me mjedisin ligjor si dhe praktikave e sfidave në zbatimin e tij. Kështu që pranohet se fusha të tjera çështjesh mund të jetë e nevojshme të rishikohen dhe të shtohen në variante të ardhshme të Matricës, për të reflektuar edhe çështje apo fusha më me rëndësi për rajone e vende të tjera.

Zhvillimi i parimeve, standarteve dhe indikatorëve është bërë duke marrë në konsideratë liritë dhe të drejtat themelore ndërkombëtare si dhe praktikat më të mira rregullatore në nivelin e Bashkimit Evropian dhe në vendet europiane.

Matrica është e organizuar rreth tre fushave, secila e ndarë në nën-fusha. Fushat kryesore janë:

1. Garancitë Themelore Juridike të Lirive;
2. Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OJF-të;
3. Marrëdhënia Qeveri -OSHC.

Fushat janë përcaktuar nëpërmjet parimeve kryesore të cilat janë përpunuar më tej nëpërmjet standarteve specifike. Në mënyrë që t'i krijojnë mundësi OSHC-ve lokale, donatorëve apo palëve të tjera të interesuara për të rishikuar apo monitoruar mjedisin ligjor dhe praktikat e aplikimit të tij, standartet janë të shpjeguara më tej përmes indikatorëve.

Fusha e parë është "Garancitë Themelore Juridike të Lirive". Kjo fushë adreson çështje që janë thelbësore për ekzistencën e shoqërisë civile - liria themelore e gjithsecilit për t'u organizuar, për të përmirësuar jetën e tyre, dhe për të ndjekur qëllime dhe ëndrra të përbashkëta: liria e organizimit. Gjithsesi, liria e organizimit nuk qëndron e vetme. Ajo garantohet dhe duhet të ushtrohet së bashku me lirinë e grupimeve dhe lirinë e individëve apo grupeve për të shprehur mendimet e tyre. Matrica thekson parimin kryesor që tre liritë themelore të organizimit, grupimit dhe shprehjes duhet të garantohen dhe ushtrohen lirisht nga çdokush.

Pasi OSHC-ja është krijuar, ajo kërkon akses në burime në mënyrë që të mbështesë aktivitetet e saj. Matrica detajon llojet e burimeve që përdoren zakonisht nga OSHC-të, në formën e përfitimeve financiare (përfitimet tatimore, gjenerimi i të ardhurave, filantropia dhe mbështetja nga shteti) dhe burimet njerëzore (mbështetja tek punonjësit dhe vullnetarët). Parimet kryesore në këtë seksion theksojnë se OSHC-të dhe donatorët duhet të gëzojnë trajtim tatimor të favorshëm për të mbështetur aftësitë e OSHC-ve për të gjeneruar të ardhurat e tyre personale dhe për të mobilizuar burimet lokale. Në rastet e mbështetjes nga shteti, parimi kryesor është që kjo ndihmë duhet të sigurohet në mënyrë transparente dhe të përdoret në mënyrë të përgjegjshme. Parimi i tretë thekson nevojën për politika shtetërore dhe mjedis ligjor për të stimuluar dhe lehtësuar zhvillimin e burimeve të qëndrueshme njerëzore për sektorin përmes punësimit, vullnetarizmit dhe angazhime të tjera në OSHC.

Fusha e tretë dhe e fundit fokusohet në marrëdhënien midis OSHC-ve dhe qeverisë, ndonëse parimet mund të aplikohen gjithashtu edhe në marrëdhëniet me parlamentin dhe autoritetet lokale. Kjo është ndoshta fusha më sfiduese, sepse aplikimi i parimeve dhe standarteve varion gjerësisht mes vendeve në varësi të sfidave të ndryshme, më domethënësia e të cilave është sjellja e

autoriteteve publike ndaj shoqërisë civile dhe aftësia e shoqërisë civile për të qënë një partner i fortë e i besueshëm. Gjatë përcaktimit të standarteve dhe indikatorëve, ekspertët morën në konsideratë diversitetin domethënës në praktikë, por gjithashtu kushtuan kujdes në përcaktimin e minimumit të nevojshëm për të siguruar ndërtimin domethënës të marrëdhënive për të mirën e qytetarëve.

Kjo fushë e tretë është e ndarë në tre nën-fusha. Nën-fusha e parë ka të bëjë me kuadrin dhe praktikën për bashkëpunim, dhe parimi kryesor kërkon një përqasje strategjike për vazhdimësinë e bashkëpunimit shtet-OSHC dhe zhvillimit të OSHC-ve si një themel për marrëdhënien. Nën-fusha e dytë adreson kërkesën në rritje për të siguruar që politikën dhe ligjet janë bërë me një pjesëmarrje të lartë të qytetarëve dhe OSHC-ve. Fusha e tretë përfshin rritjen e bashkëpunimit dhe përfshirjes së OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve të ndryshme që janë të kontraktuara nga apo të deleguara tek OSHC-të (p.sh. shëndeti, shërbimet sociale, kërkimet, etj.).

Indikatorët e matricës nuk synojnë të krijojnë pikë apo renditje mes vendeve, por janë indikator përshkrues. Ata synojnë të udhëzojnë palët e interesuara (OSHC-të, qeveritë dhe donatorët) në të kuptuarin më mirë të mjedisit ligjor e të politikave dhe zbatimit të tij praktik kundrejt standarteve dhe praktikave ndërkombëtare. Qëllimi është t'i ndihmojë ata të nxjerrin mësim mbi fushat që kërkojnë reformime të mëtejshme, si të adresojnë sfidat dhe t'i ndihmojnë ata të vendosin prioritetet ndër çështjet për reformim.

Së fundmi, meqenëse përqasja bazë për zhvillimin e Matricës bazohet në kuadrin e ECNL-së për vlerësimin dhe matjen e mjedisit mundësues në vende të ndryshme; përshkrimi i plotë i secilit nivel dhe komponent mund të gjendet në faqen e ECNL.¹

Niveli 1 – Standartet minimale. Në vende me regjime shtypëse apo në situatë konflikti/pas konflikti, duhet të synohet vendosja e një minimumi standartesh në ligje dhe praktikë që kërkojnë nga ligjet ndërkombëtare (më tepër konventat që kanë nëshkruar partnerët qeveritarë, si ICCPR -Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, ECHR -Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore). Raporti për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile përcakton qartësisht këto standarte minimale, duke

përfshirë: (i) lirinë e organizimit; (ii) lirinë e shprehjes; (iii) të drejtën për të vepruar lirisht pa ndërhyrjen e pajustificuar të shtetit; (iv) të drejtën për të patur akses në burime; (v) të drejtën për komunikim dhe bashkëpunim, përfshirë edhe ndërkombëtarisht; (vi) detyrën e shtetit për të mbrojtuar.

Niveli 2 – Zhvillimi i sektorit të OSHC-ve. Në vendet ku garantohen standartet minimale por sektori i OSHC-ve është ende në zhvillim dhe ka nevojë për mbështetje në zhvillimin e tij, është e rëndësishme të kuptohet që është gjithashtu përgjegjësi e qeverisë të investojë në këtë proces. Zakonisht në vende të tilla zhvillimi i sektorit të OSHC-ve (p.sh. ndërtimi i kapaciteteve në mënyrë që ata të drejtojnë organizata dhe projekte më efektive) financohet nga donatorë ndërkombëtarë, gjë që çon në një varësi të përgjithshme nga fondet e huaja. Nëse synohet të ketë një partneritet domethënës midis qeverisë dhe shoqërisë civile, ky trend duhet të mbështetet me investime dhe ndërhyrje strategjike që sigurojnë mjedisin mundësues si nga qeveria ashtu edhe nga donatorët.

Niveli 3 – Partneriteti. Në vendet ku ka një sektor të gjerë të OSHC-ve që disponojnë njëfarë niveli burimesh të tyre, dhe ku ka patur mjaftueshëm diversitet (p.sh. krijimi i segmenteve të OSHC-ve, si p.sh. ato të orientuara drejt advokacisë dhe shërbimeve, organizatat komunitare, fondacionet, think tanks, etj.) fokusi mund të vihet në realizimin e marrëdhënive publike-private më efektive në mënyrë që qytetarët të jenë përfituesit kryesorë dhe të vërtetë në këtë marrëdhënie. Është pikërisht në këtë fazë kur bën më tepër sens propozimi i gjërave të tilla si mekanizma të institucionalizuara për bashkëpunim, apo kontraktimi i OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve sociale².

1 www.ecnl.org

2 Ky është një fragment nga dokumenti i ECNL-së paraqitur KE-së "Consultation Paper Preparing the European Commission Communication on Civil Society Organisations in Development", 2012. Për më tepër informacion kontaktoni ECNL.

Fusha 1:
Garancitë themelore
juridike
të lirive

Nën-fusha 1.1 Liria e organizimit

Parimi: Liria e organizimit është e garantuar dhe ushtrohet lirisht nga të gjithë

| STANDARTI 1 | INDIKATORËT |
|---|--|
| <p>Të gjithë individët dhe subjektet juridike mund të themelojnë, t'i bashkohen apo të marrin pjesë lirisht në organizata jo-formale apo të regjistruara, offline dhe online.</p> | <p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Ekziston një kuadër ligjor sipas të cilit çdo person mund të krijojë shoqata, fondacione dhe lloje të tjera subjektësh jo-fitimprurëse, jo-qeveritare (p.sh. kompani jo-fitimprurëse) për çfarëdo qëllimi. 2) Kuadri ligjor lejon si personat juridikë dhe individët të ushtrojnë këtë të drejtë pa diskriminim (moshe, kombësie, kapaciteti ligjor, gjinie etj). 3) Regjistrimi nuk është i detyrueshëm, dhe në rastet kur organizatat vendosin të regjistrohen, rregullat e regjistrimit janë të përcaktuara në mënyrë të qartë që të lejojnë një proces regjistrimi dhe apelimi të lehtë, jo shumë të gjatë në kohë dhe të pakushtueshëm. 4) Ligji lejon për krijimin e rrjeteve midis organizatave në vendet e tyre dhe jashtë, pa njoftim paraprak. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Çdo person fizik apo juridik në praktikë mund të formojë shoqata, fondacione apo forma të tjera organizimesh jo-fitimprurëse, jo-qeveritare offline apo online. 2) Personat fizikë dhe juridikë nuk sanksionohen për mos-regjistrimin e organizatave të tyre. 3) Regjistrimi është me të vërtetë i arritshëm brenda afateve të përcaktuara me ligj; autoritetet vendosin mbi rastet në mënyrë jo-subjektive dhe apolitike. 4) Individët dhe OSHC-të mund të formojnë dhe të marrin pjesë në rrjete dhe koalicionet, brenda dhe jashtë vendeve të tyre. |

SHPJEGIMI

Legjislacioni

Garancia e lirisë së organizimit duhet të përmbahet në Kushtetutën e një vendi dhe duhet të zhvillohet më tej e të bëhet funksionale përmes një ligji i cili udhëheq të gjithë ciklin jetësor të organizatave që nga themelimi, veprimtaria, qeverisja, aktivitetet e deri tek mbyllja apo shpërbërja.

Bazuar në ligjin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, liria e organizimit i ofrohet çdo individ, qoftë ky qytetar vendas, i huaj, refugjat, grua, fëmijë, person me aftësi të kufizuara apo tjetër. Liria e organizimit nuk do të thotë vetëm që dikush mund të themelojë një organizatë apo

ndonjë formë tjetër ligjore jo-fitimprurëse (organizata/OSHC), por që dikush mund t'i bashkohet (ose jo) një organizate/ OSHC-je ekzistuese si një anëtar që merr pjesë në aktivitetet apo qeverisjen e përditshme të kësaj organizate. Nuk duhet të ketë detyrime ligjore për t'u bërë anëtar apo për të marrë pjesë në punën e një organizate. Në të njëjtën kohë, organizatat/OSHC-të nuk duhet të ndalohen që të kufizojnë anëtarësinë në disa grupe apo kategori specifike. Lidhur me këtë, nuk duhet të ketë një limit në numrin e organizatave me qëllime të ngjashme, ku njerëzit mund të bashkohen për të arritur një rezultat apo qëllim të caktuar në atë fushë, apo të shprehin këndvështrimet e tyre (në fjalë të tjera, ekzistenca e një organizate që merret me të drejtat e grave nuk duhet të ndalojë ekzistencën

e organizatave të tjera me të njëjtin fokus). Kjo liri nuk shtrihet vetëm në një formë ligjore-shoqatën. Ajo përqafon gjithashtu edhe të drejtën për të formuar apo për t'iu bashkuar fondacioneve, partive politike, organizatave fetare, sindikatave, shoqatave të punëdhënësve, kompanive jo-fitimprurëse, dhe formave të tjera organizatash të ndryshme.³

Objektivat e OSHC-ve të regjistruara duhet të jenë të ndryshme dhe kufizimet e vetme janë ato të njohura nga ligji ndërkombëtar. OSHC-të duhet të lejohen të punojnë në fusha të ndryshme dhe të ndjekin të gjitha synimet legjitime duke përfshirë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, parandalimin e diskriminimit, etj. Një OSHC mund të promovojë edhe një ndryshim në rendin kushtetues por vetëm në rastet kur: "a) nëse kjo bëhet në mënyrë ligjore me mjete demokratike; dhe b) nëse vetë ndryshimi i kërkuar është në përputhje me parimet demokratike"⁴

Liria e organizimit shtrihet gjithashtu edhe përmes Internetit apo grupeve të ndryshme sociale si Facebook. Bazuar në këtë, bllokimi i Internetit apo i disa aplikacioneve të caktuara (Skype, Facebook) përmes të cilave grupet mund të formojnë apo të ndërmarrin aktivitete, do të konsiderohej një dhunim i kësaj të drejte.⁵

② Liria e organizimit nuk shtrihet vetëm në individë por edhe në persona juridikë (p.sh. korporata). Si rrjedhojë, ligjet në vend duhet të lejojnë që bizneset apo entitete të tjera ligjore të themelojnë apo t'i bashkohen shoqatave, fondacioneve, federatave apo llojeve të tjera të subjekteve jo-fitimprurëse e jo-qeveritare. Për më tepër, siç u vu re edhe më sipër, çdo person, pavarësisht gjinisë, kombësisë dhe moshës, ka të drejtën t'i bashkohet (ose jo) një organizate. Ndërkohë që mund të ketë disa kërkesa në

3 Siç mund të vihet re edhe në Hyrje, Matrica diskuton çështjet mbizotëruese që rreth lirisë së formimit të shoqatave, fondacioneve dhe kompanive jo-fitim prurëse, si format më të zakonshme në të cilat shprehet e drejta. Ekspertët njohin ekzistencën e formave të tjera (p.sh. shoqatave të biznesit, sindikatave) dhe se disa çështje në këtë Matricë u përkasin edhe këtyre subjekteve (p.sh. pjesëmarrja në politikë-bërje)

4 Mataga, Zvonimir, The Right to Freedom of Association under the European Convention on the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms, tetor 2006, fq.10.

5 Deklaratë e Maina Kiai, Raportuese Speciale për të drejtat dhe liritë e mbledhjeve dhe organizimeve paqësore, në sesionin e 20-të të Këshillit të të Drejtave të Njeriut.

lidhje me kapacitetet ligjore dhe moshën ligjore të personave që mund të bëhen themelues të një organizate, këto kërkesa nuk duhet t'i pengojnë atyre lirinë e të vendosurit për t'u bërë anëtarë, për t'iu bashkuar apo për të qeverisur OSHC-në e tyre.

Bazuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, njerëzit me aftësi të kufizuara, përfshirë ata me aftësi të kufizuara mendore dhe psiko-sociale (shëndeti mendor), kanë të drejtë të marrin pjesë në jetën politike e publike. E drejta është e pakufizuar, çka do të thotë që ajo vlen për këdo, pavarësisht faktorëve të tillë si gjinia, lloji i aftësisë së kufizuar, shkalla e rëndësës së aftësisë së kufizuar dhe statusi ligjor lidhur me aftësinë e kufizuar siç është kujdestaria.⁶

③ Nuk duhet të ketë asnjë kërkesë ligjore për regjistrimn e OSHC-ve dhe vendimi për këtë gjë i përket vetëm themeluesve/anëtarëve. Një shembull i shkeljes së këtij parimi është rasti kur njerëzit e asociuar me organizatën janë gjobitur apo persekutuar për shkak të fillimit të implementimit të aktiviteteve para se të jetë konfirmuar regjistrimi si entitet ligjor.

Kur themeluesit vendosin të regjistrojnë organizatën, procedura e marrjes së statusit ligjor është qartësisht e përshkruar në ligj. Organizatat që plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore u jepet personaliteti juridik. Nuk ka procedura të rënduara, si nevoja për të patur një numër të madh themeluesish (praktikisht është mirë të jenë mes 2-5 themelues). Tarifat e mbledhura nga agjencia e regjistrimit (gjykata, ministria, regjistri qendror, etj.) nuk konsiderohen të larta në krahasim me nivelin e jetesës së vendit përkatës. Ato nuk dekurajojnë aplikimin dhe gjithkush duhet të jetë i aftë të përballojë pagesën e tyre.

Vendimet për regjistrimet merren shpejt (midis 5 deri 30 ditëve) dhe aplikantët duhet të informohen me shkrim për vendimin. Vendimet negative për regjistrimin mund të jenë subjekt i një ankese në gjykatë apo në një organ tjetër të pavarur. Në rastet kur vendimi nuk është marrë ende brenda afatit të paracaktuar, duhet të supozohet që organizata mund të fillojë veprimtarinë e saj dhe kjo të pranohet edhe nga organe të tjera shtetërore (nëse ekziston nevoja

6 Komente të nxjerra nga Qendra për Advokimin mbi Aftësinë e Kufizuar Mendore (2013)

për një regjistrim vijues p.sh. me agjencinë e sigurimeve shoqërore, ky institucion bie dakort që organizata është e regjistruar dhe nuk e ka të nevojshme një vendim regjistrimi me shkrim).

④ Liria e organizimit shtrihet në rrjetet e organizatave, koalicionet e tyre, federata apo lloje të tjera sindikatash. Duhet të mundësohet komunikimi me grupet jashtë vendit, dhe për këtë nuk duhet të ketë kufizime. Gjithashtu kjo liri shtrihet edhe në organizimet online. Bllokimi i nismave të rrjetit social me synim pengimin e komunikimit mes njerëzve/organizatave, duhet të ndjekë limitet e lejuara të cilat aplikohen për lirinë e organizimit. Një shembull kufizimi mbi të drejtën për t'iu bashkuar rrjeteve apo shoqatave jashtë vendit janë kërkesat ndaj OSHC-ve që të informojnë apo marrin leje nga autoritetet shtetërore për të bërë një gjë të tillë, dhe përballja e tyre me gjopa nëse nuk e bëjnë këtë lajmërim.

Praktika:

① Praktikisht ka lloje të ndryshme OSHC-sh: ka shembuj organizatash të ngritura nga gratë, nga njerëz me kapacitete ligjore të kufizuara apo grupe të tjera të pafavorizuara. Kompani dhe individë apo grupe të tjera mund të formojnë shoqata, fondacione dhe subjekte jofitimprurëse ka shembuj të tillë, ose edhe kur nuk ka shembuj të tillë, nuk ka ankesa për moslejimin e kompanive për t'u bërë themelues ose bashkëthemelues të OSHC-ve. Përveç kësaj, duke u bërë themelues apo president që nuk merr shpërblim, individit nuk konsiderohet si një punonjës në vetvete, dhe nuk humbet përfitimet apo statusin e të qënurit i papunë. Për më tepër, shteti nuk e konsideron personin e punësuar në OSHC si një person që ka ndërmarrë një funksion publik dhe si i tillë të jetë subjekt i të njëjtit shqyrtim si zyrtar publik.

Nuk ka kufizime për aplikacione në Internet, grupet e Facebook-ut nuk janë të ndaluara, faqet e internetit të organizatave apo llogaritë e tyre bankare nuk janë të bllokuara apo pre e piraterisë, fjalëkalimet e tyre nuk janë vjedhur, ose ndryshuar të dhënat, dhe Skype apo forma të ngjashme komunikimi virtual nuk monitorohen. Grupet apo individët përdorin mjetet e TIK për të kryer aktivitete të përbashkëta dhe nuk ka ankesa për kufizime nga ana e qeverisë apo ngacmime nga moderatorët (liderët informal të grupeve) apo anëtarët e grupeve.

② Në praktikë qeveria nuk u kërkon themeluesve që të regjistrojnë organizatën për të ndërmarrë aktivitete apo të vendosë gjopa për subjektet ligjore të peregjistruara. Nuk ka raste apo ankesa për refuzime të paarsyeshme apo të pajustificuara të rregjistrimit. Në shoqëri ka organizata të peregjistruara. Si një praktikë e mirë, organizatat e peregjistruara janë të pranishme në jetën publike, dhe bashkëpunojnë me OSHC të tjera apo organe të tjera shtetërore.

③ Nuk ka raste të raportuara të influencës politike gjatë procesit të regjistrimit. Vendimet janë të bazuara në ligje dhe jo në interpretime subjektive të kërkesave ligjore. Për regjistrim nuk kërkohen dokumenta shtesë, veç atyre të përshkruara në ligj.

④ Praktika është mundësuese, dhe ka shembuj të rrjetëzimit të lirë të organizatave si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Organizatat mund t'i bashkohen grupeve apo sindikatave ombrellë ndërkombëtare, t'i bashkohen rrjeteve online duke përdorur mjete të ndryshme TIK, mund të ndërmarrin aktivitete (duke vajtur atje apo duke ftuar në vend anëtarë të tjerë të rrjetit, e duke i organizuar aktivitetet në nivel kombëtar, rajonal apo ndërkombëtar) dhe të promovojnë qëllimet e tyre. Regjistrimi në rrjete është i thjeshtë. Organizatat nuk përballen me kërkesa burokratike të rënduara që vështirësojnë rrjetëzimin, si kërkesat për të lajmëruar një organ specifik shtetëror nëse planifikojnë që t'i bashkohen një rrjeti.

| STANDARTI 2 | INDIKATORËT |
|---|--|
| <p>OSHC-të veprojnë lirisht pa ndërhyrje të pajustificuara të shtetit në qeverisjen dhe aktivitetet e tyre të brendshme.</p> | <p>Legjislacioni: Kuadri ligjor ofron garanci kundër ndërhyrjes së shtetit në çështjet e brendshme të shoqatave, fondacioneve apo llojeve të tjera të subjekteve jo-fitimprurëse. 2) Shteti siguron mbrojtje nga ndërhyrje të palëve të treta. 3) Raportimi financiar (duke përfshirë rregulloret e pastrimit të parave) dhe rregullat e kontabilitetit konsideron natyrën specifike të OSHC-ve dhe janë në proporcion me madhësinë e organizatës dhe llojin / qëllimin e aktiviteteve të saj. 4) Sanksionet për shkeljen e kërkesave ligjore duhet të bazohen në legjislacionin në fuqi dhe të ndjekin parimin e proporcionalitetit. 5) Kufizimet dhe rregullat për shpërbërjen dhe mbylljen plotësojnë standartet e ligjeve ndërkombëtare dhe janë të bazuara në kritere objektive të cilat kufizojnë vendimmarrjen arbitrare.</p> <p>Praktika: 1) Nuk ka raste të ndërhyrjes shtetërore në çështjet e brendshme të shoqatave, fondacioneve apo llojeve të tjera të subjekteve jo-fitimprurëse. 2) Nuk ka praktika të mbikëqyrjeve okupuese të cilat të imponojnë kërkesa të rënduara raportimi. 3) Sanksione aplikohen në raste të rralla / ekstreme, ato janë proporcionale dhe janë subjekt i një shqyrtimi gjyqësor.</p> |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

① Ka shumë bazë të kufizuar për ndërhyrjen e shtetit në lirinë e organizimit dhe ato janë të parashikuara në ligjet ndërkombëtare. Më i përshtatshëm për vendet evropiane është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktika ligjore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut e cila parashikon terrenin për limitet dhe jep interpretime të mëtejshme nëpërmjet praktikave ligjore. Bazuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, limitet e lirisë së organizimit lejohen nëse:
 (1) parashikohen nga ligji; (2) kanë një qëllim legjitim; (3) janë të nevojshme në një shoqëri demokratike.

Në vijim në pikën 2, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut konsideron si legjitime synimet vijuese: (1) në interes të sigurisë kombëtare publike; (2) për parandalimin e krimit dhe prishjes së rendit; (3) për mbrojtjen e shëndetit dhe moralit; (4) për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

OSHC-të janë të pavarura nga shteti, dhe ligji duhet t'u garantojë atyre të drejtën për të rregulluar strukturën e tyre të brendshme dhe procedurat vepruese. Për shembull, ligji nuk duhet të lejojë shtetin të ndërhyjë në manaxhimin e brendshëm të punëve së tyre. Kërkesa të tilla si mandati i pjesëmarrjes së një përfaqësuesi shtetëror në takimet e një trupi organizativ do ta dhunonte këtë indikator. Në mënyrë të ngjashme, ligji nuk duhet të lejojë shtetin të ndërhyjë në procesin e emërimeve të anëtarëve të Bordit.

Ligji nuk duhet të kërkojë që OSHC-të të marrin miratim paraprak nga shteti për kryerjen e aktiviteteve të tyre. Shteti mund t'u kërkojë këtyre organizatave t'u nënshtrohen disa regjistrimeve/liçensimeve për fusha të ndryshme ku organizatat do të punojnë apo ku interesat e grupeve të pafavorizuara duhet të mbrohen (p.sh. shërbimet për fëmijët). Megjithatë, këto situata duhet të parashikohen qartësisht në ligj dhe OSHC-të nuk duhet të diskriminohen krahasuar me ofruesit e tjerë të këtyre shërbimeve (shiko Nën-fushën 3.3 për më tepër shtjellim mbi këtë).

② Shtetet nuk kanë vetëm detyrimet negative – të mos dhunojnë lirinë e organizimit dhe të lejojnë veprimtarinë e OSHC-ve, por kanë edhe detyrime pozitive – të mbrojnë lirinë e organizimit, duke përfshirë parandalimin e dhunimit të kësaj lirie nga palë të treta. Kjo do të thotë që shteti ka ngritur masa për të mbrojtur të drejtën – p.sh., forca të policisë për të mbrojtur njerëzit kundër dhunimeve të të drejtave të tyre nga aktorë shtetërorë ose jo-shtetërorë, dhe një gjyqësor të pavarur të aftë për të ofruar zgjidhje.³ Kështu që, nëse puna e një grupi pengohet nga ajo e një grupi tjetër (p.sh., organizatat Rome dhe grupet LGTB), kuadri ligjor duhet të ketë garancitë që shteti mund të mbrojë punën e tyre.

③ Rregulloret mbi raportimet e OSHC-ve duhet të bazohen në karakteristikat e punës që bën OSHC-ja. Raportet që ato paraqesin duhet të përshtaten me aktivitetet e OSHC-së. Një praktikë e mirë rregullatore është ajo e të pasurit një legjislacion të veçantë mbi llogaritë dhe format e raportimeve jo-fitimprurëse, të cilat janë të ndryshme nga format raportuese të bizneseve. Në këtë mënyrë, informacioni i mbledhur nga autoritetet do të jepte një panoramë më të mirë të asaj që sektori i OSHC-ve është duke bërë realisht, pa shtuar detyrime të panevojshme ndaj sektorit. Një praktikë e mirë rregullatore është ajo e prezantimit të kërkesave më të lehta të raportimit për organizata të vogla që bien nën një prag të caktuar.

OSHC-të nuk duhet të jenë subjekt i kërkesave më të rrepta lidhur me pastrimin e parave, sesa ato të cilave u nënshtrohen subjekte të ngjashme si p.sh. bizneset apo tipe të tjera organizatash jo-fitimprurëse. Rregulloret që kërkojnë raportim specifik financiar apo masa specifike lidhur me kërkesa kundër-terrorizmit të cilat nuk janë në proporcion me përmasat e organizatave dhe që i trajtojnë OSHC-të ndryshe nga ofruesit e tjerë, do të ishin në kundërshtim me këtë indikator.

④ Të gjitha sanksionet, subjekt i të cilave janë edhe OSHC-të, duhet të parashikohen me ligj dhe duhet të jenë të qarta që të shmangin ndonjë keqinterpretim të mundshëm në praktikë. Sanksionet për OSHC-të duhet të jenë të njëjta, madje më të ulëta, krahasuar me sanksionet për kompanitë për shkelje të ngjashme. Nëse ka sanksione materiale (gjoja, etj.) këto duhet të marrin në konsideratë edhe

situatën financiare të organizatës. Të gjitha sanksionet duhet të jenë në proporcion me shkeljet e bëra. Gjobat për individët përgjegjës duhet të jenë raste të veçanta; ato duhet të aplikohen vetëm në rastet e shkeljeve të qëllimshme dhe serioze të ligjit. Ligjet nuk duhet të parashikojnë gjoja më të larta për individët përgjegjës sesa për organizatën.

⑤ Ligji duhet të lejojë OSHC-të të zgjedhin të shpërbëhen në çdo kohë, me anë të një rezolute të organit më të lartë shtetëror. Ligji duhet të parashikojë saktësisht dhe në detaje situatën kur organizatat mund të shpërbëhen dhe terrenin për mbylljet e pavullnetshme (p.sh. në rastet e shkeljes së statutit apo ligjit). Mbyllja duhet të ndodhë vetëm si një mjet i fundit dhe duhet të lejohet apeli. Si një praktikë e mirë, mbyllja duhet të vendoset në një seancë gjyqësore. Duhet të aplikohet vetëm pasi të jenë kryer të gjitha sanksionet dhe kur shihet se nuk ka asnjë mënyrë tjetër për të rregulluar situatën. Një shembull i vendimit për mbylljen në mënyrë disproporcionale është rasti kur një organizatë mbyllet pasi ka dështuar në paraqitjen në kohë të raportit të saj vjetor. Edhe pse kjo konsiderohet si një shkelje serioze, organizatës duhet ti jepet mundësia p.sh. të paraqesë raportin ose të paguajë një gjobë. Vetëm nëse dështon edhe kjo alternativë atëherë mund të merret në konsideratë sanksioni i mbylljes së organizatës.

Praktika:

① Praktika tregon se OSHC-të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe nuk ka raportime ku OSHC-të të kenë qënë subjekt i kërcënimeve të qeverisë për punën e tyre. Nuk ka shembuj të ndërhyrjes së qeverisë në ambientet e subjekteve ligjore private, apo vizita/kontrolli 'surprizë' në zyra apo në takimet e bordit. Kërkesa që OSHC-të të punojnë vetëm me banka specifike të kontrolluara nga qeveria dhe të përdorin vetëm shërbime të ofruara nga qeveria, nuk do të ishte koherente me këtë indikator. Nuk ka ndërhyrje specifike ndaj organizatave që janë kritike ndaj qeverisë. Nuk duhet të ketë shembuj të përpjekjes së shtetit për të sulmuar këto lloj organizatash.

② Ndërhyrja/sulmi nga ana e shtetit mund të marrë formën e auditimeve të tepruara ndaj një organizate me qëllim vënien e kufizimeve administrative dhe sanksionimin e organizatës. Shembuj të tjerë përfshijnë inspektime

të targetuara dhe kontrole të tepruara të rregullores së punësimit apo masa të tjera administrative.

③ Sanksionimi i një organizate duhet të ketë synim rregullimin e një shkelje dhe jo pengimin e veprimtarisë së organizatës. Kur vendoset një sanksion, vëmendje i duhet kushtuar karakterit specifik të OSHC-së dhe llojit të shkeljes. Praktika duhet të tregojë se kur ka diferenca mes ndëshkimeve minimale dhe maksimale, gjobat vendosen në bazë të madhësisë së organizatës, peshës së shkeljes dhe në përgjithësi të tregojë se ka një tendencë të vendosjes së gjobave më të ulëta e jo më të larta. Vendimet për kufizim të të drejtave apo mbylljen e organizatave praktikisht ndodhin në një proces gjyqësor në një mënyrë apolitike, vendimet shpjegohen dhe organizatat mund të apelojnë ndaj tyre.

| STANDARTI 3 | INDIKATORËT |
|--|---|
| <p>OSHC-të marrin dhe sigurojnë të ardhura financiare nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit për të mbështetur aktivitetin e tyre.</p> | <p>Legjislacioni: 1) Legjislacioni lejon OSHC-të të angazhohen në aktivitete ekonomike. 2) OSHC-të lejohen të marrin fonde të huaja. 3) OSHC-të lejohen të marrin fonde nga individët, korporatat dhe burime të tjera.</p> <p>Praktika: 1) Legjislacioni për OSHC-të që angazhohen në aktivitete ekonomike zbatohet dhe nuk përbën barrë për OSHC-të. 2) Nuk ka kufizime (p.sh. barrë administrative ose financiare, pre-miratim, apo kanalizim të fondeve të tilla nëpërmjet organeve të veçanta) për OSHC-të për të marrë fonde të huaja. 3) Marrja e financimit nga individët, korporatat dhe burime të tjera është e lehtë, efektive dhe pa ndonjë kosto të panevojshme apo barrë administrative.</p> |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

① “Aktivitete ekonomike” do të thotë shitja aktive e mallrave dhe shërbimeve, të cilave i referohemi si aktivitete “tregtare apo biznesi”; ato përfshijnë shitjen e mallrave dhe shërbimeve në vazhdimësi ose rregullisht.⁷ Këtu mund të përfshihet: pagesa për shërbime, shitje, qera, investime, dhe sipërmarrje biznesi. Legjislacioni duhet të lejojë OSHC-të të angazhohen si në mënyrë të drejtpërdrejtë (si një OSHC) edhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë (duke regjistruar apo patur në pronësi aksionet e një kompanie komerciale) në aktivitetin ekonomik. Ndërkombëtarisht kjo konsiderohet një e drejtë e rëndësishme duke qenë se lejon OSHC-të të gjenerojnë të ardhura nëpërmjet zhvillimit të shërbimeve të tyre, të përmirësojnë shtrirjen në komunitetet e tyre, të adoptojnë shërbimet për të plotësuar nevojat reale, dhe të kenë një burim të qëndrueshëm të të ardhurave, të pavarur nga shteti.

Mund të ketë disa kufizime për përfshirjen e drejtpërdrejtë në një aktivitet ekonomik. Për shembull: aktiviteti ekonomik mund të duhet të

7 Survey of the Treatment of Economic Activities of Non- Profit Organizations in Europe, ICNL, ECNL, MCIC, 2007

jetë i lidhur me misionin e organizatës (p.sh. një organizatë për personat me aftësi të kufizuara mund të ofrojë shërbime transporti për personat e tillë, ose organizatat për personat e verbër mund të shesin bastuna për ecje); aktiviteti ekonomik mund të jetë një aktivitet shtesë për aktivitetin jo-fitimprurës; ose rregullat mund të kërkojnë që të gjitha të ardhurat të përdoren për synimet e organizatës. Duhet të ketë ndalim të shpërndarjes së të ardhurave neto tek palët të cilat mund të jenë në pozicion të kontrollojnë organizatën për përfitime personale si themeluesit, anëtarët, nëpunësit, drejtorët, agjentët, apo të punësuarit (ndalimi i shpërndarjes së të ardhurave). Autoritetet shtetërore duhet të ofrojnë udhëzime lidhur me përfshirjen në aktivitete ekonomike për të lehtësuar procesin.

② Legjislacioni nuk duhet t’u kufizojë OSHC-ve mundësinë për të marrë financime nga burime të huaja publike apo private. Financime të tilla duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë si edhe financimet nga burimet lokale. Çdo kërkesë ligjore për regjistrimin e financimeve të huaja (përveç financimeve nga donatorët dypalësh që janë nën rregulloren e BE), miratimi i tyre paraprak nga qeveria, kërkesa për kanalizimin e financimeve të huaja përmes bankave apo organeve të kontrolluara nga shteti, janë të papajtueshme me këtë indikator.

③ Nuk ka kufizime ligjore që mund të ndalojnë marrjen e financimeve nga çdo person privat apo tregtar, shteti, autoritetet lokale, fondacionet apo subjektet e tjera ligjore, agjenci, etj. Me fjalë të tjera, OSHC-të duhet të jenë të afta të gjenerojnë fonde nga individë e korporata, dhe të marrin pjesë në prokurimet publike apo në tenderimet e financimeve a shërbimeve nga shteti ose donatorët.

Praktika:

① OSHC-të përfshihen në aktivitete ekonomike. Ato mund të ngrenë kompani për këtë qëllim ose të përfshihen drejtpërdrejtë. Autoritetet shtetërore nuk imponojnë zbatimin e rregulloreve që do të kufizonin këtë të drejtë. Kur OSHC-të përfshihen në një aktivitet ekonomik, ato janë subjekt i çdo kërkesë licencimi/ regjistrimi apo çdo lloj tjetër regjimi të veçantë nëse këto kërkohen për çdokënd që përfshihet në atë fushë pune përkatëse.

② OSHC-të marrin financime të huaja dhe mund t'i përdorin ato për atë qëllim për të cilin financimi është dhënë. Në rastet e marrjes së financimeve të huaja, nuk ka procedura specifike administrative që pengojnë organizatat të marrin këto lloj financimesh. Nuk ka taksa specifike për marrjen e financimeve të huaja. Nëse sigurohet heqja e TVSH-së, procedura për marrjen e saj është e lehtë, e thjeshtë për t'u zbatuar dhe jo shumë e rëndë.

③ OSHC-të mund të marrin lirisht financime nga burime të ndryshme private, dhe nuk përballen me procedura të komplikuar për të siguruar këto financime.

Nën –fusha 1.2: Liritë e tjera

Parimi : Liritë e organizimit dhe të shprehjes janë të garantuara për të gjithë.

| STANDARTI 1 | INDIKATORËT |
|---|---|
| <p>Përfaqësuesit e OSHC-ve individualisht apo përmes organizatave të tyre, gëzojnë lirinë e organizimeve paqësore.</p> | <p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Kuadri ligjor është i bazuar në standardet ndërkombëtare dhe siguron të drejtën e lirisë së organizimit për të gjithë pa asnjë diskriminim. 2) Ligjet i njohin dhe nuk i kufizojnë mbledhjet spontane, simultane . 3) Ushtrimi i së drejtës nuk është subjekt për autorizim paraprak nga autoritetet, por më e shumta për një procedurë njoftimi paraprak, e cila nuk është e rëndë. 4) Çdo kufizim i së drejtës bazuar në ligj dhe lëshuar nga autoriteti rregullator mund të apeloher nga organizatorët. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Nuk ka raste të shkeljes së lirisë së tubimit, dhe çdo grup njerëzish mund të mbledhet në vendin dhe kohën e dëshiruar, në përputhje me dispozitat ligjore. 2) Kufizimet janë të justifikuar me shpjegimin e arsyes për çdo kufizim, i cili i komunikohet menjëherë me shkrim organizatorit për të garantuar mundësinë e apelit. 3) Mbledhjet simultane, spontane mund të kryhen, dhe shteti lehtëson dhe mbron grupet për të ushtruar të drejtën e tyre kundër njerëzve të cilët synojnë për të parandaluar ose prishur mbledhjen. 4) Ka raste të lirisë së mbledhjes të praktikuar nga OSHC-të (individualisht ose nëpërmjet organizatave të tyre) pa autorizim paraprak, kur njoftimi nevojitet ai dorëzohet në një periudhë të shkurtër kohe dhe nuk kufizon mundësinë për të organizuar mbledhjen. 5) Nuk ka përdorim të tepruar të forcës të ushtruar nga organet e zbatimit të ligjit, duke përfshirë këtu edhe ndalimin apo dënimin e organizatorëve dhe pjesëmarrësve. 6) Media duhet të ketë qasje sa më të madhe nëpër mbledhje. |

SHPJEGIMI

Legjislacioni

① Liria e mbledhjes paqësore është një e drejtë themelore e njeriut, e sanksionuar në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile e Politike, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian dhe traktateve të tjera ndërkombëtare e rajonale, dhe e ndërthurur pazgjidhshmërisht

me lirinë e organizimit. Shteti ka një detyrim pozitiv për të lehtësuar dhe mbrojtur organizimet paqësore - liria e organizimit duhet të gëzohet në mënyrë sa më të pakufizuar, të garantohet me ligj dhe nuk duhet të pengohet nga procedura administrative apo rregullore të panevojshme.⁸

Ligji duhet të sigurojë lirinë e organizimit për të gjithë, individët dhe personat juridikë, personat pa shtetësi, refugjatët, shtetasit e huaj, azilkërkuesit, emigrantët dhe të tjerë.

8 OSCE/OIDHR- Udhëzimet e Komisionit të Venecias mbi Lirinë e Organizimeve Paqësore, edicioni i 2të, 2010

② Ligji duhet të lejojë mbajtjen e grumbullimeve paqësore në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë (në mënyrë simultane) dhe organizimin e anti-mitingjeve (të grupeve opozitare). Në rastet kur disa grupime planifikojnë të bëjnë organizime në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë, ata kanë të drejtë të bëjnë një gjë të tillë vetëm nëse rrethanat fizike e lejojnë një gjë të tillë. Në rastet e organizimeve me qëllime kundërshtuese mes dy grupeve (anti-mitingjet) ligji duhet të njohë përgjegjësinë e shtetit për të ndërmarrë masa për mbrojtjen e pjesëmarrësve në organizimet paqësore nga individë apo grupe individësh, duke përfshirë agjentët provokues apo kundër-demonstruesit, të cilët synojnë të ndërpresin apo shpërndajnë këto lloj organizimesh.

③ Ligji duhet të ketë një parashikim në favor të mbajtjes së tubimeve. Ata që duan të realizojnë një tubim nuk duhet t'u kërkohet të marrin leje paraprakisht. Nëse një kërkesë e tillë ekziston, atëherë ajo duhet të reduktohet thjesht në një lajmërim (vënie në dijeni për organizimin e një eventit të tillë), dhe jo kërkesë për autorizim (duke kërkuar leje për të bërë një gjë të tillë). Nuk duhet të ketë kufizime për të bërë lajmërimet përpara se të merret leja. Kërkesa për lajmërimet mund të justifikohet nga detyra e shtetit për të mbrojtur rendin publik, sigurinë publike dhe të drejtat e liritë e të tjerëve.

④ Ligji duhet të garantojë të drejtën e apelimit ndaj vendimeve për kufizimet e tubimeve.

Praktika:

① Ka raste të praktikimit të lirisë së tubimit nga OSHC-të (individualisht ose përmes organizatës së tyre) pa autorizim paraprak. Kur kërkohet lajmërimi, ai dorëzohet në një kohë të shkurtër dhe nuk e kufizon mundësinë e organizimit të tubimeve. Nuk ka ankesa për kufizime mbi tubimet, grupet nuk e kanë të detyrueshme të kërkojnë autorizim paraprak, dhe as policia nuk ua kërkon në rastet kur organizohen tubimet. Çdo kufizim ndjek rastet e përshkruara në ligj për kufizimet. Grupet mund të organizojnë tubimet kudo. Një dhunim i kësaj të drejte do të ishte në rastin kur shteti në mënyrë të qëllimshme rezervon një vend të caktuar në mënyrë që të ndalojë organizimin e tubimit. Si rregull, tubimet duhet të organizohen aty ku mund të "dëgjohen dhe shikohen" nga audienca që synohet.

② Autoritetet rregullatore japin një shpjegim të menjëhershëm, të detajuar dhe objektiv për çdo kufizim të tubimeve. Kur ka mohim arbitrar apo kur autoritetet rregullatore dështojnë për t'iu përgjigjur në mënyrë të menjëhershme, atëhere kjo konsiderohet si një kufizim i tepruar i lirisë së tubimeve. *"Kur ka një dështim në dhënien e një përgjigjeje të menjëhershme, atëhere ligji duhet të parashikojë që organizuesit e tubimit mund të vijojnë sipas kushteve të njoftimit."* Kur autoritetet kufizojnë këtë të drejtë, ka mundësi apelimi.

③ Shteti nuk ndërhyr në tubimet spontane duke ngritur argumentin e nevojës së njoftimit të autoriteteve. Tubimet simultane dhe anti-mitingjet mund të zhvillohen, dhe autoritetet e zbatimit të ligjit ushtrojnë kontrollin e nevojshëm për të mbrojtur protestuesit paqësorë, duke pranuar që tubimi duhet të realizohet brenda grupit të tyre të synuar. Tubimet nuk ndalohen gjerësisht sepse ekziston mundësia e kundër-mitingjeve, por më së tepërmi përdoren metoda mbrojtëse për të ndarë grupet dhe për të minimizuar dhunën e mundshme apo prishjen e rendit publik.

④ OSHC-të ose individët organizojnë tubime dhe këto nuk shpërndahen për shkak të mungesës së autorizimit paraprak të lëshuar nga autoritetet shtetërore. Në rastet e tubimeve spontane, lajmërimi paraprak nuk përdoret si arsye për të shpërndarë tubimet paqësore.

9 Lëvizja Botërore për Demokraci në Ndihma Kombëtare për Demokraci dhe ICNL, Raporti i Mbrojtjes së Shoqërisë Civile, botimi i 2të, 2012

5 Pjesëmarrësit në tubime paqësore nuk bëhen subjekt dënimi. Nuk ka raste kur organizatorët e tubimeve, apo protestues të njohur të jenë ndaluar në mënyrë që të mos lejohet të ndodhë tubimi. Zyrtarët e zbatimit të ligjit nuk përdorin forcën kundër protestuesve dhe as përdorin metoda të tilla për të shpërndarë tubimet paqësore. Nuk ka ankesa për përdorim force të tepruar ndaj kërcënimeve të shkaktuara.

6 Duke qënë se qëllimi kryesor i tubimeve është t'i përcjellë një mesazh grupit të synuar, medias duhet t'i garantohet akses në to.

| STANDARTI 2 | INDIKATORËT |
|---|--|
| <p>Përfaqësuesit e OSHC, individualisht apo përmes organizatave, gëzojnë lirinë e shprehjes.</p> | <p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Korniza ligjore siguron lirinë e shprehjes për të gjithë. 2) Kufizimet, të tilla si kufizime të të folurit me urrejtje, të imponuara nga legjislacioni janë të përshkruara qartë dhe në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. 3) Shpifja përbën më tepër një kundravajtje se sa pjesë e kodit penal. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Përfaqësuesit e OSHC, sidomos organizatave për të drejtat e njeriut dhe watch dog, gëzojnë të drejtën e lirisë së shprehjes në çështje që ata mbështesin dhe ndaj të cilave janë kritikë. 2) Nuk ka raste të shkeljes së të drejtës së lirisë së shprehjes për të gjithë. 3) Nuk ka raste ku individë, duke përfshirë përfaqësues të OSHC-ve do të persekutoheshin për fjalime kritike, në publik apo private. 4) Nuk ka asnjë sanksion për fjalimin kritik, në publik apo privat, sipas kodit penal. |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

① Liria e shprehjes është një e drejtë themelore e cila është e përshtatur në disa dokumenta ndërkombëtarë, duke përfshirë edhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Kjo është një liri e rëndësishme për individët dhe OSHC-të. Është veçanërisht e rëndësishme për OSHC-të që janë të angazhuara në të drejtat e njeriut dhe promovimin e demokracisë duke qënë se kjo i lejon ato jo vetëm të shprehen lirisht por edhe të përfshihen në advokim. Kuadri ligjor duhet të garantojë këtë të drejtë për të gjithë. Nuk ka iniciativa ligjore për të kufizuar të drejtën e marrjes së informacionit dhe lirinë e shprehjes, përfshirë edhe informacionet në internet.

② Çdo kufizim i lirisë së shprehjes duhet të parashikohet dhe të legjitimohet domosdoshmërisht me ligj. Një indikator mund të jenë komentet ndaj ligjeve ekzistuese nga ekspertë të ndryshëm, të cilët theksojnë që ligjet janë në të njëjtën linjë me standartet ndërkombëtare. Disa shkelje që duhet të shmangen do të ishin: ligji nuk duhet të

imponojë kërkesën e lejes për të folur publikisht apo për të bërë prezantime / dhënë leksione; dhe nuk duhet të ketë një kërkesë që publikimet e organizatave të miratohen paraprakisht. Ligji nuk duhet të përmbajë pohime të gjera, konfuzuese të cilat mund të jenë burim i interpretimeve subjektive. Gjykatat mbrojnë të drejtën e lirisë së shprehjes kur ajo dhunohet, duke shqyrtuar rastet dhe duke marrë vendimet në kohë.

③ Kodi penal nuk rregullon shpifjen. Për qëllimin e Matricës, ky indikator duhet marrë në konsideratë në shkallën që influencon OSHC-të dhe anëtarët e tyre në ushtrimin e lirisë së shprehjes.

Praktika:

- ① Ka raste të vazhdueshme në praktikë ku organizatat e të drejtave të njeriut dhe ato watchdog (vëzhguese) mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për t'u shprehur, kritikuar dhe ndërmarrë veprime për arritjen e misionit të tyre, që mund të targetojë edhe politikatat shtetërore. Mjetet e komunikimit (faqet e internetit, emaillet, faqet e Facebook) nuk bllokohen apo bëhen subjekt i piraterisë.
 - ② Nuk ka ankesa të pajustificuara nga grupe, organizata, media apo individë që ata të jenë ndaluar në ndonjë lloj forme të shprehin opinionet apo pikëpamjet e tyre, brenda kufizimeve ligjore.
 - ③ Nuk ka ankesa të pajustificuara, raportime në media apo nga organizatat kombëtare e ndërkombëtare se grupe, organizata apo individë të jenë kërcënuar, persekutuar, apo që ndihen të frikësuar për sigurinë e tyre.
 - ④ Çështjet gjyqësore që lidhen me shpifjet trajtohen si kundravajtje. Nuk ka dënime me burgim për fjalimet kritike. Kompensimet e vendosura në këto raste janë të arsyeshme.
-

| STANDARTI 3 | INDIKATORËT |
|---|---|
| <p>Përfaqësuesit e shoqërisë civile, individualisht dhe përmes organizatave të tyre, kanë të drejtën për të marrë dhe ndarë informacion të sigurtë përmes çdo media.</p> | <p>Legjislacioni: 1) Kuadri ligjor ofron mundësinë për të komunikuar nëpërmjet dhe për të patur akses në çfarëdo burim informacioni, duke përfshirë Internetin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK); nëse ka kufizime ligjore këto janë të rralla, të kufizuara dhe në bazë të ligjeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. 2) Kuadri ligjor ndalon monitorimin pajustificuar të kanaleve të komunikimit, duke përfshirë Internetin dhe TIK, ose mbledhjen e informacionit të përdoruesit nga ana e autoriteteve.</p> <p>Praktika: 1) Nuk ka raste në praktikë, ku janë vendosur kufizime mbi qasjen e çfarëdo burimi informacioni, përfshirë internetin apo TIK. 2) Interneti është gjerësisht i arritshëm dhe i përballueshëm. 3) Nuk ka asnjë praktikë apo raste monitorimi të pajustificuar nga ana e autoriteteve, të kanaleve të komunikimit duke përfshirë internetin apo TIK, ose mbledhjes së informacionit të përdoruesit. 4) Nuk ka raste të ngacmimit të anëtarëve të grupeve të rrjeteve sociale nga ana e policisë.</p> |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

① Ligji nuk duhet të përmbajë asnjë ndalesë për mënyrën se si përdoret interneti apo TIK, në vend apo më gjerë, që nuk është e justifikuar nga standardet e gjera ndërkombëtare.

Ndërkombëtarisht, dispozitat ligjore që vijojnë përdoren për të limituar të drejtat: ligjet penale të përdorura për shprehjen në Internet; ligjet që imponojnë përgjegjësi ndaj ndërmjetësve për dështimin në filtrimin apo bllokimin e përmbajtjeve të konsideruara të paligjshme, kërkesat për internet kafetë për të marrë informacion/foto të përdoruesve të internetit; ndalime të përdorimit të Facebook, Skype, YouTube, Twitter apo metoda të tjera TIK.

① Kuadri ligjor (parashikime specifike në ligjet përkatëse, ligjet penale, apo aktet e përshtatura për rregullimin e komunikimit dhe TIK) duhet të përmbajnë garanci themelore kundër çdo monitorimi ilegal të kanaleve të komunikimit apo mbledhjes së të dhënave të përdoruesve.

Praktika:

① Kufizimet e të drejtave mund të përfshijnë: masat teknike si bllokimi dhe filtrimi i disa faqeve të ndryshme, qoftë faqes së organizatës në web apo në median sociale. Praktika duhet të tregojë që nuk ka ankesa apo raste të tilla.

② Aksesit në internet është i lirë dhe teknikisht i disponueshëm për të gjithë. Qeveria inkurajon dhe mbështet ngritjen e hapësirave publike me akses falas në internet dhe Wi-Fi për përdorim nga të gjithë qytetarët. Nuk ka kërkesa për identifikimin e përdoruesve apo mbajtjen e të dhënave hyrëse në pikat e aksesit publik të internetit. Ndërkohë që indikatorit mund të jetë i gjerë dhe i përgjithshëm, është e rëndësishme të dëshmohet mbi situatën e përgjithshme në të cilën OSHC-të punojnë dhe kanë akses në internet / TIK.

③ Nuk ka ankesa, raportime mediatike apo raste gjyqësore për monitorime të pajustificuara apo mbledhje të informacionit të përdoruesve, sidomos ato të pabazuara në urdhër gjykatë të bazuar në ligj që përputhet me standardet ndërkombëtare.

④ Ka shembuj të formimit të grupeve online

përmes rrjeteve sociale (p.sh., Facebook). Individët nuk detyrohen të japin detaje për pjesëmarrjen në grupin e rrjetit social ku ata bëjnë pjesë, dhe nuk ka raste bllokimi të emaileve të anëtarëve të ndonjë grupi të rrjeteve sociale.

Fusha 2 :
Kuadri për
Qëndrueshmërinë dhe
Lehtësirat Financiare
për OJF-të.

Nënfusha 2.1: Trajtimi tatimor/fiskal për OSHC-të dhe donatorët e tyre.

| STANDARTI 1 | INDIKATORËT |
|---|---|
| <p>Përfitimet tatimore janë të vlefshme për burime të ardhurash të ndryshme të OSHC-ve</p> | <p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Ligji parashikon trajtim tatimor falas për të gjithë grantet dhe donacionet që mbështesin aktivitetin jo-fitimprurës të OSHC-ve. 2) Ligji siguron përfitime tatimore për aktivitetet ekonomike të OSHC-ve. 3) Ligji siguron përfitime tatimore për investimet pasive të OSHC-ve. 4) Ligji lejon krijimin dhe siguron përfitime tatimore për Dhurimet e Kushtëzuara (Endowments). <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Nuk është raportuar asnjë taksë mbi grantet direkte ose indirekte (e fshehur). 2) Përfitimet tatimore për aktivitetet ekonomike të OSHC-ve janë efektive dhe mbështesin funksionimin e OSHC-ve. 3) Investimet pasive janë shfrytëzuar nga OSHC-të dhe nuk janë aplikuar sanksione për të tilla investime. 4) Dhurimet e kushtëzuara që mundësojnë gjenerimin e të ardhurave (Endowments) janë krijuar pa vështirësi të mëdha procedurale dhe veprojnë lirisht, pa ndonjë barrë administrative apo kosto të lartë financiare. |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

① Të ardhurat nga burime tradicionale jo-fitimprurëse të OSHC-ve si dhurime private apo të korporatave, grantet dhe tarifat e anëtarësimit nuk janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat apo taksimit të korporatës. Ligjet e tatimeve duhet të kenë përjashtime të mirëpërcaktuara nga taksat e të ardhurave që vijnë nga këto lloj burimesh.

② Si një praktikë e mirë rregullatore, të ardhurat nga aktivitetet ekonomike duhet të përjashtohen nga taksat. Ligji mund të sigurojë përjashtim të plotë për të gjitha OSHC-të, ose përjashtim të plotë për organizatat e përfshira në aktivitetet me përfitim publik (ose ato që kanë statusin e përfitimit publik / bamirës). Në rastet kur nuk ka përjashtim të plotë, ligji mund të taksojë aktivitetet ekonomike por me një shkallë taksimi më të ulët, ose mund të parashikojë përjashtime nën një prag të caktuar. Të ardhurat nga qeraja e pronësisë së OSHC-ve

mund të kualifikohen si të ardhura nga aktiviteti ekonomik.

③ Investimi i aseteve të një organizate për t'i shtuar ato, konsiderohet si investim pasiv. Është pasiv sepse ky nuk është synimi kryesor i organizatës (nëse krahasohet me kompanitë investuese) por në momentin që organizata disponon disa asete është mirë që t'i menaxhojë ato me kujdes. Zakonisht investimet pasive synojnë të ndihmojnë një organizatë të zhvillojë qëndrueshmërinë dhe stabilitetin afat-gjatë të veprimtarisë të saj. Investimet pasive mund të përfshijnë të ardhura nga depozitat bankare, nga kursi i këmbimit, dividendët, shitja e aksioneve, etj.

Përjashtimet më bazike përfshijnë përjashtimin nga taksat mbi interesin e depozitave bankare dhe dividendët nga pronësia mbi një kompani (apo aksioneve në të).

④ Një dhurim i kushtëzuar është kapitali / asetet e një organizate të cilat investohen, duke përdorur vetëm të ardhurat nga investimet për të drejtuar organizatën dhe programet e

saj. Disa nga çështjet kryesore të lidhura me dhurimet e kushtëzuara janë: kush mund të krijojë një të tillë?; kush i menaxhon ato?; cilat janë kërkesat për të investuar në to?; dhe cilat janë kërkesat për të shpenzuar dhurimet dhe të ardhurat e marra prej tyre?

Duhet të ketë një mundësi për OSHC-të, nën disa kushte të caktuara, për të investuar asetet e tyre. Në dhurimet e kushtëzuara të zakonshme, mund të ketë kufizime se ku asetet mund të investohen (për të garantuar stabilitetin e organizatës). Mund të ketë kufizime në shpenzimin e këtyre dhurimeve – një kërkesë që shpenzimet vjetore të një organizate të përbëjnë një përqindje të caktuar të këtyre dhurimeve, ose që të ardhurat nga dhurimet e kushtëzuara të mos mbulojnë vetëm shpenzimet administrative. Një çështje shumë e rëndësishme është nëse ka dhe cilat janë kufizimet ligjore të vendosura për shpenzimin e vetë këtyre dhurimeve, për të vlerësuar nëse ligji stimulon krijimin e dhurimeve të kushtëzuara.

Nxitjet për dhurimet e kushtëzuara janë zakonisht dy llojesh – nxitje për të ardhura nga dhurimet e investuara (të ngjashme me nxitjet për investimet pasive) dhe nxitjet për donatorët që sigurojnë dhurime të mëdha për krijimin e dhurimeve të kushtëzuara. Një shembull i përfitimit të një donatori dhurimesh të kushtëzuara është rasti kur dhurimet mbi 1 milion EUR mund të llogariten dhe të zbriten nga të ardhurat për një periudhë 10 vjeçare.

Praktika:

1 Taksa indirekte mbi grantet mund të përfshijë çdo lloj pagese të fshehur e cila duhet paguar p.sh. ndaj autoriteteve ku ndodhet selia e organizatës, apo bankës ku kryhen veprimet me grantin. Një tarifë normale bankare nuk do të përfshihej nën këtë kategori përveç rastit, për shembull, nëse përbën një përqindje të grantit të marrë.

2 Përfitimet fiskale për aktivitetet ekonomike duhet të jenë të thjeshta dhe të drejtpërdrejta. Nëse ka shumë kushte për t'u përmbushur në mënyrë që ato të përdoren, kjo do të përbente një problem praktik për OSHC-të. Përdorimi i përfitimeve fiskale mund të jetë e vështirë për OSHC-të kur kërkohen shumë dokumente, duke marrë parasysh edhe procedurat e komplikuar administrative. Nëse vetëm një numër i vogël organizatash kanë përfitime fiskale, ky mund të jetë një indikator që përfitimet nga taksat janë më tepër dekurajuese sesa mundësuese.

3 Koncepti i investimit pasiv kuptohet dhe pranohet nga autoritetet shtetërore, dhe në praktikë ato e diferencojnë atë nga aktiviteti ekonomik i OSHC-ve.

4 Ka shembuj të dhurimeve të kushtëzuara që veprojnë në vend. Të ardhurat nga dhurimet e kushtëzuara janë të mjaftueshme për të mbuluar një pjesë të madhe të veprimtarisë së organizatës së cilës i jepet ky dhurim. Për më tepër, nuk ka ankesa apo raste të raportuara për procedura të vështira për krijimin apo përdorimin e këtyre dhurimeve.

| STANDARTI 2 | INDIKATORËT |
|---|---|
| <p>Ofrohen lehtësira për të nxitur dhurimet nga individë dhe korporata</p> | <p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Ligji parashikon zbritje nga taksat për dhurime individuale apo nga korporatat për OSHC-të. 2) Ka kërkesa/ kushte të qarta për marrjen e dhurimeve për të cilat ka ulje nga taksat dhe këto përfshijnë një gamë të gjerë aktiviteteve në dobi të publikut. 3) Politikat shtetërore në lidhje me përgjegjshmërinë sociale (CSR) marrin në konsideratë nevojat e OSHC-ve dhe i përfshijnë ato në programet e tyre. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Ekziston një procedurë funksionale për të kërkuar zbritje taksash për dhurime individuale apo të korporatave. 2) Organizatat e Shoqërisë Civile janë partnerë me shtetin në promovimin e CSR. 3) OSHC-të që punojnë në fushat kryesore të interesit publik, duke përfshirë të drejtat e njeriut dhe organizatat mbikëqyrëse, në mënyrë efektive përfitojnë dhurime për të cilat aplikohet ulje taksash. |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

① Si individët ashtu edhe korporatat që dhurojnë duhet të përfitojnë disa përjashtime nga taksat për dhurimet që bëjnë. Përjashtimet janë zakonisht në formën e zbritjeve – zvogëlimin e bazës mbi të cilën është vendosur taksa e të ardhurave / e korporatës. P.sh. nëse të ardhurat janë 1000 EURO dhe keni bërë një dhurim 100 EURO, atëherë taksa duhet të vendoset mbi diferencën – 900 EURO.

Një formë më pak e përhapur e përfitimeve tatimore është taksë e zbritshme – taksa e zbritshme lejon donatorin të zbresë një pjesë të shumës së dhuruar nga taksat që duhet të paguajë, dmth. ata reduktojnë shumën e taksës së papaguar.

Mund të ketë një limit në shumën e dhurimeve që mund të zbritet, e cila mund të bazohet në të ardhurat ose në fitimin apo qarkullimin (në rastet e kompanive).

Është e rëndësishme të merret gjithashtu në konsideratë se kush përfiton lehtësira tatimore – donatorët për të gjitha OSHC-të, apo donatorët e segmenteve më të vogla të organizatave

(p.sh. organizatat me status për përfitim publik ose vetëm organizatat që punojnë në fusha të caktuara). Përfitimet ekzistojnë jo vetëm për njerëzit që punojnë me kontrata pune, por gjithashtu edhe për njerëz që disponojnë të ardhura nga qerata apo nga aktivitetet e tyre private (p.sh. kompozitorët, shkrimtarët, personat e vetëpunësuar).

② Përfitimet tatimore për dhurimet janë përgjithësisht të vlefshme si për aktivitetet që përgjithësisht konsiderohen me përfitim për publikun (p.sh. aktivitetet në fushën sociale, të kujdesit shëndetësor apo edukimit, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, etj.) ashtu edhe për organizatat që kanë fituar një status të caktuar përfitimi tatimor (p.sh. statusi i përfitimit publik). Në rastet kur ligji liston aktivitetet, ai duhet të përqafojë një listë të gjerë fushash dhe të përfshijë fushat e të drejtave të njeriut dhe demokracisë (të cilat janë ato që përfitojnë më tepër nga dhurimet). Ligjet nuk duhet të përshkruajnë procedura të rënda për të pretenduar përfitime tatimore, procese që kërkojnë përfshirjen dhe/ose miratimin nga disa organe shtetërore. Të gjithë kërkesat proceduriale duhet të jenë të thjeshta; donatorëve nuk u duhet kërkuar të kalojnë në procedura të rënda për të justifikuar përfitimet tatimore. Përfitimet tatimore duhet të jenë totalisht të aplikueshme në praktikë

dhe donatori dhe përfituesi duhet të kenë siguri ligjore mbi faktin nëse dhurimi plotëson kriteret për përfitim tatimor, përpara angazhimit për të dhënë një dhurim të tillë. Donatorët nuk duhet të mbajnë përgjegjësi për përdorimin që i bëhet dhurimit për përfitim publik (përveç rasteve të korrupsionit).

③ Në të gjitha dokumentat strategjike apo politike që lidhen me përgjegjshmërinë sociale të biznesit, OSHC-të konsiderohen si një partner dhe përfitues kyç dhe aty adresohen nevojat e OSHC-ve.

Praktika :

① Proçedura e përdorimit të përfitimeve tatimore për dhurimet nuk është e komplikuar dhe dokumentet e kërkuara nuk janë të vështira për t'u siguruar. Ekziston mundësia për njerëzit që nuk paraqesin deklaratën e taksave vjetore që të përdorin përfitimet përmes punëdhënësve të tyre apo në ndonjë mënyrë tjetër. Kur ekziston mundësia për të zbritur një dhurim për një periudhë disa vjeçare, kjo aplikohet korrektësisht. Të dhënat tregojnë se njerëzit e përdorin të drejtën e tyre për të zbritur dhurimet (do të ishte një shenjë negative nëse njerëzit preferojnë të mos përballen me "burokracitë" dhe të mos paraqesin dokumente për përdorimin e përfitimeve tatimore për shkak të proçedurave të komplikuar).

② Të gjitha dokumentet politikave në fushën e përgjegjshmërisë sociale të biznesit përgatiten dhe zbatohen në bashkëpunim me OSHC-të. Në praktikë ekzistojnë shembuj dhe iniciativa mbi partneritete që promovojnë përgjegjshmërinë sociale të biznesit për sektorin civil.

③ Në rastet e kufizimeve specifike mbi kategoritë e OSHC-ve që mund të përfitojnë dhurime me taksë të reduktuar, kjo listë përfshin organizatat më tipike të përfitimit publik p.sh. organizatat e të drejtave të njeriut, organizatat që punojnë në fushën e kujdesit shëndetësor, shërbimeve sociale dhe edukimit, etj. Ndërkohë që mund të ketë kategori të tjera përfituesish të dhurimeve me taksë të reduktuara (p.sh. spitalet, galeritë, muzetë) të cilat nuk janë OSHC, përfitimet që ato gëzojnë janë të njëjta me përfitimet e dhurimeve për OSHC-të.

Nën-fusha 2.2

Mbështetja e shtetit

Parimi 4:

Mbështetja e shtetit ndaj OSHC-ve jepet në një mënyrë transparente dhe përdoret në mënyrë të përgjegjshme

| STANDARTI 1: | INDIKATORËT |
|--|---|
| <p>Financimi publik është i vlefshëm për zhvillimin institucional të OSHC-ve, mbështetjen e projekteve dhe bashkëfinancimin e BE dhe granteve të tjera.</p> | <p>Legjislacioni:</p> <p>1) Ka një ligj apo politikë kombëtare (dokument), që rregullon mbështetjen shtetërore për zhvillimin institucional të OSHC-ve, mbështetje për projektet dhe bashkë-financimin e projekteve të financuara nga BE.</p> <p>2) Ekziston një mekanizëm në nivel kombëtar për shpërndarjen e fondeve publike për OSHC-të.</p> <p>3) Fondet publike për OSHC-të janë planifikuar në mënyrë të qartë në buxhetin e shtetit.</p> <p>4) Ka procedura të qarta për pjesëmarrjen e OSHC-ve në të gjitha fazat e ciklit të financimit publik.</p> <p>Praktika:</p> <p>1) Fondet publike në dispozicion u përgjigjen nevojave të sektorit të OSHC-ve.</p> <p>2) Ekzistojnë organe qeveritare me një mandat të qartë për shpërndarjen dhe / ose monitorimin e shpërndarjes së fondeve shtetërore.</p> <p>3) Financimi është i parashikueshëm, jo i prerë në mënyrë drastike nga njëri vit në tjetrin, dhe shuma e buxhetit për OSHC është lehtësisht e identifikueshme.</p> <p>4) Pjesëmarrja e OSHC-ve në ciklin e financimit publik është transparente dhe kuptimplotë.</p> |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

① Qeveria ka përshtatur një ligj, një strategji, një marrëveshje apo një dokument tjetër i cili përmban hapat që duhet të ndjekë qeveria për të mbështetur zhvillimin e shoqërisë civile apo OSHC-të dhe punën e tyre, sidomos lidhur me mbështetjen financiare. Është e rëndësishme që ky dokument të targetojë shoqërinë civile si të tërë dhe jo vetëm ndonjë segment apo nënsektor të saj (p.sh. vetëm organizatat që ofrojnë shërbime sociale). Shembuj të fushave që janë rregulluar me ligj në vende të ndryshme përfshijnë:

- Proçesin e pjesëmarrjes së OSHC-ve dhe qytetarëve në vendimmarrje;
- Mbështetjen e vullnetarizmit;
- Mbështetjen e filantropisë;
- Masat për mbështetjen e qëndrueshmërisë financiare të OSHC-ve;

- Vendosjen e një mekanizmi specifik për dhurimet e shtetit ndaj OSHC-ve, etj.

② Mekanizmi për shpërndarjen e fondeve publike duhet të targetojë OSHC-të në mënyrë specifike. Mekanizmi mund të jetë i centralizuar (të gjitha fondet për OSHC-të në nivel kombëtar shpërndahen nga një entitet) ose i decentralizuar (mund të ketë shumë agjenci që ofrojnë fonde për OSHC-të në fusha të ndryshme dhe/ose në nivel lokal). Mekanizmi mund të menaxhohet nga një fond i posaçëm (Estoni, Kroaci), nga një agjenci e veçantë (Shqipëri), nga ministritë e fushës, ose mund të kontraktohet ndonjë OSHC (shumë nga fondet për OJF-të nën Grantet e EEA/Norvegji). Në shumicën e rasteve, mekanizmi përdoret për të shpërndarë grantet.

③ Buxheti vjetor i shtetit përmban një fond të alokuar që do të shpërndahet vetëm për OSHC-të. Kur burimi i të ardhurave për mekanizmin financues vjen nga një burim specifik (p.sh. të ardhurat nga llotaria, tarifatat për licencat mjedisore), ligji përcakton në mënyrë të qartë

masën apo përqindjen që alokohet për projektet/ zhvillimin e OSHC-ve.

④ Ekziston një kërkesë që qeveria të konsultohet me OSHC-të lidhur me prioritetet e financimit dhe programet për OSHC-të. Përfaqësuesve të OSHC-ve u kërkohet që të marrin pjesë në përzgjedhjen e projekteve nën rregullat e qarta të konfliktit të interesit. Për të siguruar pjesëmarrjen e OSHC-ve në procesin e përzgjedhjes mund të alokohet një kuotë për OSHC-të në komitetin e vlerësimit të projektit. Ekziston një kërkesë që përfaqësuesit e OSHC-ve të marrin pjesë në fazat e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të projektit/ programit.

Praktika:

① Shuma që shpërndahet nga shteti për sektorin e OSHC-ve nuk është e papërfillshme. Financimet nga shteti janë një burim domethënës të ardhurash për OSHC-të që mund të përdoret nga OSHC të ndryshme. Ndërkohë që shuma e parave që duhet alokuar për OSHC-të varion në vende të ndryshme, është e rëndësishme të merren në konsideratë faktorë të ndryshëm për të vendosur më pas nëse fondi i alokuar përputhet me nevojën, si psh: a ka burime të tjera në dispozicion të OSHC-ve? Në çfarë mase OSHC-të varen nga shteti? Cili është kapaciteti i përgjithshëm i sektorit? Cilat aktivitete nuk financohen? Dhe cila është shpërndarja totale në buxhetin e përgjithshëm? Sektori konsultohet mbi prioritetet e financimit, dhe prioritetet e financimit përfshijnë zhvillimin e shoqërisë civile. Ekzistojnë financime për mbështetje institucionale, po ashtu edhe për projekte specifike në fusha të ndryshme. Fondet publike mund të përdoren për bashkëfinancim me BE ose për projekte të tjera të financuara nga donatorët.

② Mund të ketë një ose disa organe që mund të krijohen specifikisht për shpërndarjen e financimeve të shtetit ndaj OSHC-ve, ose mund të ketë institucione ekzistuese që janë të mandatuara për financimin e OSHC-ve si pjesë e detyrimeve të tyre (p.sh. Zyrat e koordinimit të qeverisë për bashkëpunimin me OSHC-të). Organet përgjegjëse për gjenerimin e financimeve gjithashtu kanë detyrimin për të monitoruar zbatimin e projekteve të financuara.

③ Është e qartë që mbështetja e shtetit për OSHC-të nuk varet nga ndryshimet në pushtetin politik apo ndryshimet në qeveri. Shuma është

konsistente dhe pa rënie drastike.

Për më tepër, buxheti i alokuar për OSHC-të duhet të jetë i veçantë nga buxheti i alokuar për entitete të tjera jo-fitimprurëse (p.sh. në shumë vende klubet sportive janë të regjistruara si shoqata, apo organet shtetërore mund të formojnë fondacione. Shteti mund të deklarojë se mbështet shoqërinë civile ndërkohë që në fakt po mbështet sportin apo institucionet e kontrolluara nga shteti).

④ Mekanizmi nëpërmjet të cilit OSHC-të zgjidhen për të marrë pjesë në ciklet e ndryshme të procesit të financimit publik është transparent. Kur përfaqësuesit e OSHC-ve emërohen në një pozicion të caktuar apo në një organ të caktuar, lajmërimi për këtë bëhet publik dhe procesi është i hapur. Kur themelohen struktura të përbashkëta (me anëtarë nga OSHC-të dhe jo anëtarë të tyre), përfaqësuesit e OSHC-ve kanë pushtet të barabartë (p.sh. e drejta për të votuar) dhe mund të ekzistojë një balancë midis të dy kuotave (p.sh. duke lejuar numër të barabartë të përfaqësuesve të OSHC-ve dhe përfaqësuesve të tjerë).

| STANDARTI 2: | INDIKATORËT |
|--|--|
| <p>Financimi publik jepet në një mënyrë të paracaktuar dhe transparente</p> | <p>Legjislacioni: 1) Procedura për shpërndarjen e fondeve publike është transparente dhe ligjërisht detyruese për palët. 2) Kriteret për përzgjedhje janë të qarta dhe të publikuara paraprakisht. 3) Ekzistojnë procedura të qarta që adresojnë çështjet e konfliktit të interesit në vendimmarrje.</p> <p>Praktika: 1) Informacione lidhur me procedurat për financim dhe informacioni mbi projektet e financuara është në dispozicion të publikut. 2) Organet shtetërore ndjekin procedurën dhe e aplikojnë atë në një mënyrë të harmonizuar. 3) Kërkesat e aplikimit nuk përbëjnë barrë për OSHC-të. 4) Vendimet mbi tenderat konsiderohen të drejta dhe konfliktet e interesit janë shpallur paraprakisht.</p> |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

① Ekziston një mekanizëm detyrues ligjor përmes të cilit kryhet i gjithë procesi i njoftimit të procedurës për financimin dhe përzgjedhjen e projektit që do të mbështetet. Lajmërimi për procedurën është publik dhe siguron kohë të mjaftueshme për të përgatitur dhe paraqitur projekt propozimet dhe të gjitha dokumentet e nevojshme. Kur ekziston një dokument jo i detyrueshëm, psh një Kod, duhet të përfshihen në të parashikime specifike për të siguruar që organet shtetërore ndjekin procedurat dhe ekzistojnë mjetet dhe mënyrat për të adresuar rastet e shkeljeve apo mos zbatimit të procedurave.

② Kriteret dhe metodologjia për vlerësimin e projekteve janë të njohura publikisht dhe të disponueshme paraprakisht. Është e qartë se cilët komponentë e bëjnë një propozim më të fortë dhe se si ato do të vlerësohen. Propozimet e refuzuara marrin informacion mbi arsyet se përse nuk janë zgjedhur.

③ Rregullat mbi konfliktin e interesit janë pjesë e rregulloreve apo Kodeve dhe përshkruajnë qartësisht situatat dhe se si mund të shmangen ato. Për shembull, ligji mund të parashikojë që individët që kanë lidhje me organizatat aplikante, nuk mund të vlerësojnë propozimet e tyre. Ligji duhet të kërkojë që

individët të deklarojnë paraprakisht konfliktet e mundshme dhe ata duhet të zëvendësohen me vlerësues të tjerë të kualifikuar.

Praktika:

① Qeveria apo institucionet e tjera të përfshira në procesin e financimit të OSHC-ve, u kërkojnë që të publikojnë online informacionin mbi projektet e financuara – emrat dhe kontaktet e organizatës marrëse, shumica e siguruar dhe synimet dhe aktivitetet e projektit që mbështetet.

② Dokumentet e kërkuara për t'iu bashkëngjitur aplikimit për financim nuk janë të vështira për t'u siguruar dhe nuk kushtojnë shumë. Ato janë të kufizuara në numër dhe shumica prej tyre kërkojnë në momentin e nënshkrimit të kontratës. Format e aplikimit janë të qarta dhe e gjithë paketa e aplikimit është e thjeshtë për t'u përgatitur. Nuk ka kërkesa diskriminuese që të limitojnë paraprakisht pjesëmarrjen e një numri të gjerë organizatash.

③ Nuk ka shenja që përfituesit e financimeve të jenë në ndonjë mënyrë të lidhur me institucionin apo anëtarët e komisionit të cilët kanë marrë vendimin mbi alokimin e grantit. Nuk ka raste të krijimit të organizatave enkas me qëllimin për të aplikuar për financime të veçanta.

| STANDARTI 3 | INDIKATORËT |
|---|---|
| <p>Ka një sistem të qartë të llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit të financimeve publike</p> | <p>Legjislacioni: 1) Procedura për shpërndarjen e fondeve publike parashikon masa të qarta për llogaridhënien, monitorimin dhe vlerësimin e tyre. 2) Ka sanksione për OSHC-të që keqpërdorin fondet dhe ato janë në proporcion me shkeljen e procedurës.</p> <p>Praktika: 1) Monitorimi kryhet vazhdimisht dhe në përputhje me indikatorët objektivë dhe të paracaktuar. 2) Vlerësimi i rregullt i efekteve / impaktit të fondeve publike kryhet nga organet shtetërore dhe është në dispozicion të publikut.</p> |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

① Dokumentet që rregullojnë procedurat përmbajnë rregulla të qarta mbi mënyrën se si do të vlerësohet dhe monitorohet financimi i projektit dhe ata përbëjnë një pjesë integrale të sistemit/proçesit të shpërndarjes. Të gjithë përfituesve të financimeve shtetërore u kërkohet të plotësojnë një raport me detajet e përdorimit të financimit të marrë. Ndërmerret si monitorimi i dokumentave në vend ashtu edhe vlerësime të cilësisë përmes vizitave gjatë aktiviteteve.

② Sanksionet e parashikuara për shkeljet janë proporcionale me nivelin e shkeljes dhe marrin në konsideratë madhësinë e grantit dhe të organizatës. Ligji duhet të parashikojë procedura përmes të cilave OSHC-ve i jepet një mundësi për të ndrequr situatën përpara se të aplikohet sanksioni. Kur aplikohen sanksionet, autoritetet përkatëse marrin në konsideratë seriozitetin dhe qëllimin e shkeljes. Synimi i sanksioneve për shkeljet e para/të vogla është të disiplinojnë OSHC-në përkatëse.

Praktika:

① Janë caktuar ekspertë monitorimi që kryejnë vizita tek organizatat zbatuese apo eventet/aktivitetet që ato organizojnë me fonde publike, për të vlerësuar cilësinë e zbatimit. Vizita të tilla bëhen duke i dhënë organizatës njoftim paraprak. Përveç kësaj, monitorohen shpenzimet e organizatës përkundrejt buxhetit të propozuar. Nuk ka raste shqetësimesh administrative nga ana e ekspertëve monitorues. Ekziston një mekanizëm që rregullon aktivitetet apo buxhetet e projekteve bazuar në kërkesa të arsyeshme.

② Administrata e shtetit kryen një vlerësim të rregullt (çdo 3-5 vjet) të financimeve publike që shteti ofron për OSHC-të dhe përcakton se si mund të përmirësojë programin. Një vlerësim i tillë mund të realizohet nga një entitet i pavarur. Raportet e vlerësimeve postohen në faqet e internetit të institucioneve publike përkatëse në një mënyrë lehtësisht të aksesueshme.

| STANDARTI 4 | INDIKATORËT |
|--|---|
| <p>Ekziston mbështetja jo-financiare nga shteti</p> | <p>Legjislacioni: 1) Legjislacioni lejon autoritetet shtetërore të alokojnë mbështetje jo-financiare, si psh. pronë shtetërore, marrje me qera të hapësirës pa kompensim financiar (kohor), trajnime, konsultime dhe burime të tjera falas për OSHC-të. 2) Mbështetja jo-financiare ofrohet në bazë të proceseve të përcaktuara në mënyrë të qartë, duke u bazuar në kritere objektive dhe pa privilegjuar asnjë grup.</p> <p>Praktika: 1) OSHC përdorin mbështetje jo-financiare nga shteti. 2) OSHC trajtohen në mënyrë të barabartë ose përfitojnë më shumë mbështetje në krahasim me aktorët e tjerë, kur ofrojnë burime jo-financiare shtetërore. 3) Nuk ka raste të autoriteteve shtetërore që ofrojnë mbështetje jo-financiare vetëm për OSHC-të që nuk kritikojnë punën e tyre; ose e rasteve të privimit të mbështetjes për OSHC-të kritike; ose diskriminim tjetër bazuar në besnikërinë, përkatësinë politike ose terma të tjera të paligjshme.</p> |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

- ① Egziston një ligj apo rregullore që përmban parashikime që lejojnë autoritetet shtetërore të ofrojnë mbështetje jo-financiare për OSHC-të. Forma të tjera të mundshme të mbështetjes jo-financiare përfshijnë krijimin e qendrave burimore/konsultimi për OSHC-të të mbështetura nga shteti, dhe organizatave që ofrojnë trajnime të specializuara për rritjen e kapaciteteve të OSHC-ve (falas), etj.
- ② Proçedura për sigurimin e mbështetjes jo-financiare është e qartë dhe mund të përdoret nga OSHC të ndryshme. Një pjesë e mbështetjes mund të jetë e disponueshme për periudha më afatgjata. Përfundimi i marrëveshjes për marrjen me qera të ambienteve apo lloje të tjera të mbështetjeve afatgjata mund të ndodhin vetëm në kushte të limituara dhe objektivisht të matshme, pas dhënies së një njoftimi paraprak mjaftueshëm në avancë.

Praktika:

- ① Ekzistojnë shembuj dhe raportime të OSHC-ve që marrin prona apo forma të tjera të mbështetjes jo-financiare. OSHC-të e njohin këtë mundësi dhe aplikojnë për një mbështetje

të tillë.

- ② OSHC-të, sidomos ato që kryejnë aktivitete në përfitim të publikut, përfitojnë mbështetje falas apo me një çmim më të ulët se tregu. OSHC-të nuk raportojnë raste për kërkesa të rënda (qera të lartë apo kritere të cilat mund të plotësohen vetëm nga një grup i vogël OSHC-sh), trajtimi preferencial i grupeve të veçanta apo proçedura të ndryshme çdo herë.
- ③ Procesi i dhënies së mbështetjes jo-financiare ndaj OSHC-ve nuk është i njëanshëm politikisht dhe organizata të ndryshme, përfshirë edhe organizatat që janë kritike ndaj qeverisë, mund të përfitojnë prej tij. Nuk ka shembuj të organizatave që kanë marrë prona apo forma të tjera mbështetje nga qeveria paraardhëse dhe janë dëbuar përpara përfundimit të kontratës për shkak se qeveria e re i asocion ato me një forcë tjetër politike.

Nën-fusha 2.3: Burimet Njerëzore

Parimi: Politikat shtetërore dhe mjedisi ligjor stimulon dhe thjeshtëzon punësimin, vullnetarizmin dhe angazhime të tjera me OSHC-të

| STANDARTI 1 | INDIKATORËT |
|--|--|
| OSHC-të trajtohen në një mënyrë të barabartë me punëdhënësit e tjerë | <p>Legjislacioni: 1) OSHC trajtohen në mënyrë të barabartë me punëdhënësit e tjerë me ligj dhe politika.</p> <p>Praktika: 1) Nëse ka programe shtetërore për nxitje punësimi, OSHC-të trajtohen njësoj si të gjithë sektorët e tjerë. 2) Ka statistika të rregullta mbi numrin e të punësuarve në sektorin jo-fitimprurës.</p> |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

① Kur OSHC-të punësojnë njerëz, nuk ka kërkesa shtesë apo regjistrime për ato siç mund të ketë në shoqëritë tregtare.

Praktika:

① OSHC-të nuk janë të përjashtuara nga programet mbështetëse për punësimin dhe ato mund të marrin mbështetje nga shteti njësoj si sektorët e tjerë ekonomikë. Shembuj programesh mbështetëse përfshijnë punësimin e përfaqësuesve të grupeve vulnerabël, shtypsa fiskale për punonjësit apo përfaqësuesit e grupeve vulnerabël, mbështetje e kryerjes së praktikës në OSHC për studentët e sapodiplomuar, mbështetje për punësimin e të diplomuarve, subvencione për punësimin e punonjësve afat-gjatë/ për herë të parë, mbështetje jo-financiare, etj.

② Statistikat kombëtare mbledhin informacion mbi personat e punësuar në sektorin e shoqërisë civile, po ashtu edhe informacione të tjera lidhur me OSHC-të. Informacioni mund të përfshijë të punësuarit me kohë të plotë, të punësuarit me kohë të pjesshme, konsulentët apo personat me kontrata afat-shkurtra dhe vullnetarët.

| STANDARTI 2 | INDIKATORËT |
|--|--|
| <p>Ekzistojnë politika dhe ligje që mundësojnë vullnetarizmin</p> | <p>Legjislacioni: 1) Legjislacioni stimulon vullnetarizmin dhe përfshin praktikën më të mira rregullative, duke lejuar në të njëjtën kohë për praktikë spontane vullnetarizmi. 2) Ekzistojnë stimuj dhe programe të mbështetura nga shteti për zhvillimin dhe promovimin e vullnetarizmit. 3) Ekzistojnë marrëdhënie kontraktuale të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe mbrojtje për vullnetarizmin e organizuar.</p> <p>Praktika: 1) Nxitjet dhe programet janë transparente dhe lehtësisht të disponueshme nga OSHC-të dhe politika / dokumenti strategjik / ligji zbatohet plotësisht, monitorohet dhe vlerësohet periodikisht në mënyrë pjesëmarrëse. 2) Procedurat administrative për organizatorët e aktiviteteve vullnetare ose vullnetarëve nuk janë të komplikuar dhe janë pa ndonjë kosto të panevojshme. 3) Vullnetarizmi mund të bëhet në çfarëdo forme, nuk ka raste ankesash mbi kufizimeve ndaj vullnetarizmit.</p> |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

① Ligji përmban dispozitat e nevojshme për të mbrojtur vullnetarët dhe organizatat (përkufizimet, të drejtat dhe detyrimet, dispozitat kontraktuale, përfitimet fiskale të tjera, rregullat e përgjegjësive) dhe lë pjesën tjetër të përcaktohet nga palët. Ligji nuk parandalon vullnetarizmin spontan (për shembull duke kërkuar kontratë për çdo lloj vullnetarizmi). Kur një grup miqsh vendosin të pastrojnë lagjen e tyre, ligji nuk duhet t'u imponojë atyre detyrime të tilla si regjistrim paraprak, nevoja për të pasur një kontratë me një organizatë pritëse apo nevojën për t'i raportuar dikujt. Si një praktikë e mirë, nuk duhet të ekzistojnë rregullore që kërkojnë regjistrimin e vullnetarëve në autoritetet shtetërore; është mëse e mjaftueshme që organizatat të mbajnë të dhënat mbi vullnetarët dhe periudhën në të cilën ata kanë shërbyer si vullnetarë.

② Qeveria mund të përshtasë politika e programe përmes të cilave të promovohet vullnetarizmi apo të ofrojnë mbështetje të veçantë dhe trajnim për vullnetarët. Ajo mund të sigurojë gjithashtu shtysa të ndryshme të cilat zakonisht janë dy llojesh – për vullnetarët

dhe për organizatat pritëse apo që mbështesin vullnetarët.

Shtysat për vullnetarët përfshijnë mundësinë për të përdorur përfitimet (p.sh. sigurime shëndetësore apo shoqërore), e drejta për të përfituar rimbursim të shpenzimeve të mbulueshme që lidhen me shërbimin e kryer vullnetarisht (udhëtim, akomodim, dieta, etj.) dhe përjashtim nga taksa mbi të ardhurat për këtë rimbursim. Shtysat për organizatat mund të përfshijnë një program grantesh që mbështet përfshirjen vullnetare, mbështetje jo-financiare për organizatat që marrin vullnetarë, etj. Ligji mund të parashikojë që vullnetarët të marrin një librezë vullnetarizmi apo dokument tjetër rregjistruar për orët që ata kanë punuar dhe llojet e shërbimeve ku ata janë përfshirë, e cila mund të përdoret si një referencë për angazhimet e mëtejshme.

③ Ligji parashikon rregulloren bazë mbi të cilën përcaktohen përgjegjësitë e vullnetarëve dhe të organizatave që presin vullnetarë, p.sh. vullnetarët përfshirja e të cilëve tejkalon një numër të caktuar orësh ose është e vazhdueshme për një periudhë të caktuar. Ai përcakton se çfarë lloj organizatash mund të presin vullnetarët e organizuar. Ai përcakton gjithashtu se kur është e nevojshme të lidhet një kontratë mes vullnetarëve dhe organizatës, por ia lë organizatorit dhe vullnetarit që të

bien dakort për kushtet specifike të përfshirjes vullnetare. Për shembull, kontratat duhet të kërkohen vetëm për vullnetarizmin mbi një numër të caktuar orësh në muaj (p.sh. 20 orë) dhe jo në rastet kur vullnetarizmi është spontan. Megjithatë, ligji duhet të garantojë që vullnetarët të informohen rreth kushteve, të drejtave, detyrimeve dhe përfitimeve përpara se të fillojnë shërbimin vullnetar, në mënyrë që të jenë të ndërgjegjshëm për të gjitha rrethanat dhe detajet e angazhimit. Sigurimi i detyrueshëm mund të kërkohet për vullnetarët në vendet ku ka më tepër mundësi të ndodhin dëmtime fizike, si p.sh kantieret e ndërtimit.

Praktika:

① Vullnetarët mund të përdorin incentivat ekzistuese pa qenë nevoja për të kaluar nëpër procedura të ndërlikuara. Ekzistojnë incentiva konkrete për mbështetjen e vullnetarizmit që funksionon në praktikë p.sh. programet e granteve. Stimujt për vullnetarizmin dhe organizatat pritëse të vullnetarëve sigurohen në një mënyrë transparente dhe përzgjedhja e përfituesve të mbështetjes bazohet në kritere objektive. Ekziston një agjenci shtetërore/ bord ministror i cili ka mandat për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e legjislacionit dhe programet e stimujt e ndryshëm lidhur me vullnetarizmin.

② Procesi për të tërhequr vullnetarët apo për t'u bërë vullnetar nuk është i komplikuar apo i vështirë. Organizatat mund të mbështeten tek vullnetarët pa qenë nevoja që ato të regjistrohen. Nuk ka kërkesa për të regjistruar vullnetarët.

③ Mund të zhvillohet vullnetarizmi spontan dhe nuk ka shembuj të ndalimit të kryerjes së tij nga autoritetet shtetërore për mungesë regjistrimi apo miratimi. Nuk ka shembuj të kërkesës nga ana e autoriteteve shtetërore të punës, që vullnetarët të kenë marrëveshje punësimi apo të sanksionojnë organizatat për përdorim të paligjshëm të fuqisë punëtore.

| STANDARTI 3 | INDIKATORËT |
|---|---|
| Sistemi arsimor promovon angazhimin qytetare | <p>Legjislacioni:</p> <p>1) Arsimi joformal promovohet nëpërmjet politikave strategjive/ ligjeve.</p> <p>2) Subjekte të lidhura me shoqërinë civile janë të përfshira në programin zyrtar në të gjitha nivelet e sistemit arsimor.</p> <p>Praktika:</p> <p>1) Sistemi arsimor përfshin mundësi për angazhim qytetar në OSHC.</p> <p>2) Ofrimi i arsimit jo-formal nga OSHC-të njihet.</p> |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

① Qëndrueshmëria e kapitalit njerëzor, mbështetjes së përgjithshme dhe besimit në shoqërinë civile mund të sigurohen përmes masave afatgjata siç është promovimi i angazhimit qytetar. Ekziston mundësia që OSHC-të të marrin pjesë në sistemin informal të edukimit. Tematikat që lidhen me OSHC-të janë të integruara në politikat dhe strategjitë e edukimit informal.

② Si në shkolla ashtu edhe në universitete ka lëndë që i prezantojnë nxënësit/studentët me angazhimin qytetar, filantropinë, koncepte të shoqërisë civile dhe koncepte të tjera të ngjashme.

Praktika:

① Ekzistojnë programe të integruara për praktika, fellowship apo vullnetarizëm në OSHC si pjesë e kurrikulës akademike. Nxënësit/studentët janë të përfshirë në aktivitete të ndryshme sociale të organizuara në bashkëpunim me OSHC-të.

② OSHC-të kanë mundësinë të njihen si ofrues trajnimesh. Kur ka kërkesa specifike për t'u bërë trajner, OSHC-të mund të aplikojnë për të marrë një status të tillë apo për liçensë.

Fusha 3:
Marrëdhënia
Qeveri-OSHC

Nën-fusha 3.1.: Kuadri dhe praktikat për bashkëpunim

Parimi: Ka një përqasje strategjike për të vazhduar bashkëpunimin Shtet-OSHC dhe zhvillimin e OSHC-ve

| STANDARTI 1 | INDIKATORËT |
|---|---|
| <p>Shteti njeh, përmes strategjive dhe politikave, rëndësne e zhvillimit të një bashkëpunimi me sektorin</p> | <p>Legjislacioni: 1) Ekzistojnë dokumenta strategjikë që kanë të bëjnë me marrëdhëniet shtet-OSHC dhe zhvillimin e shoqërisë civile. 2) Dokumenti strategjik përfshin qëllimet dhe masat si dhe financimin në dispozicion dhe ndarje të qartë të përgjegjësisë (plane veprimi përfshirë indikatorët). 3) Dokumenti strategjik përfshin masa që janë zhvilluar në konsultim me dhe / ose të rekomanduara nga OSHC-ve.</p> <p>Praktika: 1) OSHC nga fusha të ndryshme me interes marrin pjesë rregullisht në të gjitha fazat e zbatimit strategjik të zhvillimit të dokumentit, dhe vlerësimin. 2) Ka shumë shembuj që tregojnë se bashkëpunimi mes shtetit dhe OSHC-ve dhe zhvillimi i shoqërisë civile është përmirësuar dhe zbatohet në përputhje me ose përtej masave të parashikuara në dokumentin strategjik. 3) Zbatimi i dokumentit strategjik është monitoruar, vlerësuar dhe rishikuar periodikisht. 4) Politikat shtetërore për bashkëpunim midis shtetit dhe OSHC-ve dhe për zhvillimin e shoqërisë civile janë të bazuara në të dhënat e besueshme të mbledhura nga statistikat kombëtare duke marrë parasysh larminë e sektorit.</p> |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

① Zhvillimi i shoqërisë civile dhe partneriteti me OSHC-të mund të përfshihet në më shumë dokumenta strategjikë p.sh. në planet e zhvillimit të vendit. Shumë vende, megjithatë, përshtasin dokumenta lidhur me shoqërinë civile. Këto përfshijnë dokumentat njëpalëshe (strategjitë qeveritare për zhvillimin e shoqërisë civile që përcaktojnë detyra vetëm për qeverinë) ose dokumenta dypalëshe (kontrata, programe) të cilat detajojnë iniciativat e të dyja palëve. Të gjitha këto dokumenta duhet të zhvillohen së bashku dhe të aprovohen formalisht nga qeveria apo parlamenti. Këto dokumente mund të adoptohen nga ministritë e linjës për bashkëpunime specifike me OSHC-të në fushën

e tyre të kompetencës, si shtesë ose në vend të një dokumenti të përgjithshëm të përshtatur nga qeveria apo parlamenti. Ekzistenca e dokumenteve të tilla siguron kuadrin e bashkëpunimit të përgjithshëm, dhe detajon prioritetet e mbështetjes përgjatë një periudhë një vjeçare. Në përgjithësi, konsiderohet se ekzistenca e dokumentave të tilla mbështet promovimin e politikave dhe ligjeve për një mjedis mundësues.

② Dokumentat strategjikë zakonisht shoqërohen nga plane zbatimi / veprimi të cilat përshkruajnë masa specifike dhe veprime që duhen ndërmarrë, autoritetet përgjegjëse, dhe përcaktojnë afatin në të cilin këto duhet të ndodhin. Është shumë e rëndësishme që zbatimi i aktiviteteve nën këto strategji të mbështetet financiarisht nga buxheti i shtetit përmes alokimeve specifike të buxhetit për planin.

③ Një dokument i vërtetë mbi zhvillimin e shoqërisë civile dhe/ose partneritetin ndërmjet OSHC-ve dhe organeve shtetërore nuk mund të zhvillohet pa pjesëmarrjen e OSHC-ve. Politikëbërja e mirë kërkon që OSHC-të të përfshihen në procesin e planifikimit dhe hartimit që në fillim. Është e rëndësishme që procesi i përfshirjes së OSHC-ve të jetë publik dhe transparent dhe të reflektojë nevojat e shumicës së OSHC-ve.

Praktika:

① Përveç se duhen zhvilluar në bashkëpunim me OSHC-të, dokumentat strategjikë duhet të përfshijnë OSHC-të në zbatimin dhe monitorimin e tyre. Duhet të ketë përpjekje që ky proces të jetë sa më përfshirës të jetë e mundur dhe të angazhojë OSHC-të nga fushat kryesore të sektorit të OSHC-ve. Raportet e përbashkëta mbi zbatimin e dokumentave strategjikë do të ishin një tjetër indikator konkret që OSHC-të konsiderohen dhe konsultohen në zbatim dhe vlerësim.

② Bashkëpunimi i shtetit me OSHC-të duhet të rrenjose në veprimet e institucioneve shtetërore. Ai duhet të jetë një pjesë integrale në zhvillimin e politikave dhe legjislacionit. Nuk duhet të ketë shembuj të kufizimit të bashkëpunimit p.sh. duke ngritur këshilla konsultuese të cilat nuk përdoren në politikëbërje apo duke përfshirë OSHC-të në proceset konsultuese thjesht sa për të raportuar që ka patur bashkëpunim. Ekzistojnë raporte apo shembuj që tregojnë se qeveria dhe OSHC-të kanë ndërmarrë aktivitete së bashku, ose që qeveria ka zbatuar detyrimet në adoptimin e dokumentave strategjikë.

③ Ekziston nevoja për të monitoruar rregullisht zbatimin/masat e parashikuara në dokumentat strategjikë. Kjo duhet të ndodhë çdo vit, ndërkohë që një vlerësim më i përgjithshëm mund të ndërmerret pas një periudhe më të gjatë zbatimi (p.sh. 3 deri 5 vjet). Bazuar në një monitorim dhe vlerësim të tillë, dokumentat strategjikë duhet të rishikohen për të reflektuar ndryshimet në mjedisin operues dhe për të siguruar që dokumenti të jetë i përditësuar. Organi përgjegjës për zbatimin e dokumentit duhet të zhvillojë një guidë monitorimi dhe raportimi mbi rezultatet, për aktorët e tjerë. OSHC-të duhet të jenë pjesë e procesit.

④ Në mënyrë që politikat shtetërore për shoqërinë civile t'u përgjigjen nevojave të sektorit, ato duhet të bazohen në të dhëna të besueshme. Këto të dhëna duhet të mblidhen nga statistika kombëtare apo raporte mbi zhvillimin e sektorit kryer nga organizata dhe donatorë të ndryshëm. Informacioni i mblodhur duhet të jetë në gjendje të japë përgjigje për pyetje që përfshijnë (por jo kufizohen vetëm në to): Sa OSHC janë aktive? Në cilat sektorë operojnë ato? Sa persona janë të punësuar me kohë të plotë dhe të pjesshme në sektor? Sa vullnetarë janë të angazhuar në OSHC? Cilat janë burimet e të ardhurave të OSHC-ve? Cilat janë të ardhurat e tyre? Cili është produkti që përgatitet nga sektori? Cilat janë pengesat kryesore të funksionimit të nën-sektorëve?

| STANDARTI 2 | INDIKATORËT |
|---|---|
| <p>Shteti njej, përmes veprimtarisë së institucioneve të tij, rëndësinë e zhvillimit të sektorit dhe bashkëpunimit me të</p> | <p>Legjislacioni: 1) Ekziston një institucion në nivel kombëtar ose mekanizëm me një mandat për të lehtësuar bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile (p.sh., Njësia/Zyra për bashkëpunim; pikat e kontaktit në ministri, këshill). 2) Ka dispozita të detyrueshme për përfshirjen e OSHC-ve në vendimet e marra nga institucioni kompetent apo mekanizmi (at).</p> <p>Praktika: 1) Institucioni i nivelit kombëtar apo mekanizmi (at) ka burime të mjaftueshme dhe mandat për lehtësimin e dialogut OSHC-qeveri, për të diskutuar sfidat dhe propozuar politikat kryesore për zhvillimin e shoqërisë civile. 2) OSHC të konsultohen rregullisht dhe përfshihen në proceset dhe vendimet e institucionit kompetent ose mekanizmit (ave).</p> |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

① Përveçse e rrënjësor në çdo administratë dhe pjesë e qeverisë, politika drejt OSHC-ve duhet të jetë pjesë e mandatit të një ministrie apo agjencie qeveritare. Përveç kësaj, politika të tilla mund të mbështeten nga mekanizma të ndryshëm që të lehtësojnë zbatimin në praktikë të kësaj politike. Shembuj të mekanizmave të tillë përfshijnë :

- Komisionet parlamentare që merren me çështjet e shoqërisë civile;
- Agjenci/zyra qeverie të veçanta që merren specifikisht me çështjet e shoqërisë civile;
- Organe/këshilla konsultative me anëtarë si nga qeveria ashtu edhe nga OSHC-të, të cilat fokusohen kryesisht në zhvillimin e shoqërisë civile;
- Departamente të veçanta /pika kontakti në agjenci të ndryshme qeveritare që asistojnë OSHC-të.

Kur organet konsultative formohen në përgjithësi, ato emërojnë një sekretariat apo zyrtar administrativ për të lehtësuar punën e organeve të tilla dhe për të siguruar që të arrihen rezultate praktike në kohë.

② Pavarësisht llojit të mekanizmit të zgjedhur nga vendi përkatës, si një praktikë e mirë OSHC-të duhet të konsultohen për vendimet e ndërmarra nga organi që ndikon në punën e tyre. P.sh., OSHC-të duhet të kenë mundësi të marrin

pjesë në aktet që ky organ përgatit, të cilat do të përcaktojnë edhe angazhimin e tij me sektorin (p.sh., programet vjetore, projektet, etj.). Për t'u kujdesur për këtë, rregulloret që drejtojnë punën e këtyre institucioneve duhet të përmbajnë rregulla për angazhimin dhe konsultimin e OSHC-ve. Kur marrin pjesë në një organ ndër-sektorial (p.sh. një këshill të përbashkët, komitet, etj.), përfaqësuesit e OSHC-ve duhet të paktën të jenë në numër të barabartë me përfaqësuesit e qeverisë apo të jenë të aftë të venë veton për vendime që nuk i mbështesin.

Praktika:

① Institucioni i ngarkuar për politikat e OSHC-ve ka mjaftueshëm instrumenta brenda qeverisë dhe vendimet e tij respektohen dhe ndiqen nga ministritë të cilave u adresohen. Institucioni mund të komunikojë me OSHC-të pa pengesa, ai mund t'i ftojë ato në takime apo të ndjekë aktivitetet e tyre pa qenë nevoja të merret autorizim paraprak nga ndonjë agjenci tjetër qeveritare. Për këshillat apo komisionet në të cilët marrin pjesë shumë agjenci qeveritare, niveli i pjesëmarrësve nga administrata duhet të jetë mjaftueshëm i lartë në mënyrë që të garantojë që përfaqësuesit e shtetit kanë fuqi vendimmarrëse dhe ajo çfarë ata vendosin do të zbatohet nga institucionet që ata përfaqësojnë. Ky organ duhet të marrë mjaftueshëm fonde (p.sh. buxheti shtetëror duhet të alokojë burime në baza vjetore, të cilat t'u përgjigjen funksionimit të tij) që të sigurojë aplikimin në praktikë të vendimeve dhe aktiviteteve të tij. Përveç kësaj, ai duhet të ketë në rradhët e veta anëtarë stafi të kualifikuar që të kuptojnë problemet me të cilat përballen OSHC-të dhe të kenë ekspertizë në nevojat e sektorit. Në rastin më ideal, disa prej këtyre zyrtarëve të kishin eksperiencë në OSHC.

② Ekzistojnë shembuj të OSHC-ve që marrin pjesë në grupe pune, dhe të gjitha vendimet përkatëse të këtyre organeve merren me pjesëmarrjen e OSHC-ve. Shumica e vendimeve vijnë nga rekomandime të OSHC-ve apo që mbështeten nga OSHC-të.

Nën-fusha 3.2: Përfshirja në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes.

Parimi: OSHC-të janë të përfshira efektivisht në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes

| STANDARTI 1 | INDIKATORËT |
|---|--|
| <p>Ekzistojnë standarte që mundësojnë përfshirjen e OSHC-ve në vendimmarrje, të cilat lejojnë kontributin e OSHC-ve në kohën e duhur</p> | <p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Ekzistojnë standarte të përcaktuara qartë për përfshirjen e OSHC-ve në proceset vendimmarrëse dhe të hartimit të politikave në përputhje me praktikën më të mira rregullatore që përshkrojnë kërkesat minimale që çdo proces politikë-bërës duhet të përmbushë. 2) Politikën shtetërore parashikojnë programet edukative / trajnime për nëpunësit civilë në përfshirjen e OSHC-ve në punën e institucioneve publike. 3) Rregulloret e brendshme kërkojnë që njësi të specifikuar ose zyrtarë në qeveri, ministritë e linjës apo agjenci të tjera qeveritare të koordinojnë, monitorojnë dhe raportojnë përfshirjen e OSHC-ve në punën e tyre. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Institucionet publike në mënyrë rutinore ftojnë të gjitha OSHC-të e interesuara për të komentuar mbi politika / iniciativa ligjore në një fazë të hershme. 2) OSHC-ve u ofrohet informacion adekuat për përmbajtjen e draft dokumenteve dhe detajet e konsultimeve me kohë të mjaftueshme për t'u përgjigjur. 3) Institucionet publike bëjnë publike informacione të shkruara mbi rezultatet e konsultimeve, duke përfshirë arsyet përse disa rekomandime nuk janë përfshirë. 4) Shumica e nëpunësve civilë të ngarkuar me hartimin e politikave publike kanë përfunduar me sukses programet e nevojshme arsimore / trajnuese. 5) Shumica e njësive / zyrtarëve që merren me koordinimin dhe monitorimin e konsultimeve publike janë funksionale dhe kanë kapacitet të mjaftueshëm. |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

① Kuadri ligjor duhet të parashtrijë një kërkesë për konsultim me publikun mbi draft ligjet dhe politikën. OSHC-të duhet të përfshihen që në fillim të procesit legjislativ/të politikës. Çdo proces politikëbërës, përveç formave të tjera të konsultimit, duhet të jetë subjekt konsultimesh me shkrim në të cilat teksti i aktit të jetë i disponueshëm nga publiku dhe njerëzve u lejohej të komentojnë në të. OSHC-ve dhe publikut të përgjithshëm duhet t'u jepet një

kohë e arsyeshme që të njihen me propozimin dhe të krijojnë një opinion. Kuadri ligjor duhet të parashtrijë informimin me shkrim për propozimet e marra me shpjegimin se përse disa prej tyre nuk janë pranuar. OSHC-të gjithashtu duhet të kenë akses në diskutimet e drafteve të zhvilluara dhe t'u jepet mundësia për të mbrojtur qëndrimet e tyre. Kuadri ligjor duhet të ofrojë mundësi për korrigjime nëse nuk janë respektuar dispozitat për konsultime.

Parimet e mësipërme duhet të jenë pjesë e dispozitave bazë ligjore mbi konsultimet për projekt-ligjet dhe politikën. Përveç kësaj, qeveria/Parlamenti mund të miratojë një ligj

më vete, udhëzues apo kod mbi konsultimet publike. Në rastin e dokumentave jodetyruese, duhet të merren masa specifike për të siguruar që ato të zbatohen (p.sh. më shumë investim në rritjen e ndërgjegjësimit mbi këto parashikime, monitorimin dhe trajnimin).

Së fundi, rregulla të tilla duhet të aplikohen edhe ndaj pjesëmarrjes në monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të politikave/ligjeve dhe efekteve të tyre.

② Organizimi i konsultimeve publike kërkon njohuri dhe aftësi specifike. Nëpunësit publikë të angazhuar në procesin e politikëbërjes duhet t'u nënshtrohen trajnimeve të planifikuara për të fituar këto njohuri dhe aftësi specifike si pjesë e trajnimeve në punë. Aktivitete të tilla mund të përmbajnë trajnime mbi mënyrën se si të ftohen OSHC-të, si të hartohen pyetje për komente, çfarë formash të përdorin për konsultime, etj.

③ Këta zyrtarë/njësi organizojnë procesin e konsultimit të agjencive të tyre përkatëse. Ata gjithashtu monitorojnë nivelin e përfshirjes dhe raportimit mbi procesin e konsultimit të kryer. Ekzistenca e njërive apo zyrtarëve të tillë e bën më të lehtë për OSHC-të dhe publikun që të kontaktojnë me organet shtetërore përgjegjëse për të kërkuar më tepër informacion rreth planeve të konsultimit, përfshirjes dhe miratimit të dokumentit.

Praktika:

① Ekzistojnë shumë shembuj apo iniciativa politike në të cilat OSHC-të ftohen për konsultim. Konsultime të tilla ndodhin në fazat e para në mënyrë që informacioni i dhënë nga OSHC-të të merret në konsideratë në momentin e vendosjes së drejtimit të përgjithshëm të iniciativave të rëndësishme. OSHC-ve u jepet kohë e mjaftueshme për të përgatitur një opinion (të paktën një javë para njoftimit për takime) si dhe u jepet gjithashtu mundësia për ta shprehur këtë opinion (p.sh. u jepet fjala). Një skenar ideal do të përfshinte të paktën 15-20 ditë pune në dispozicion për OSHC-të që të mund të prezantojnë opinionin e tyre. Nuk ka ankese për mungesë konsultimi mbi draftet apo për proces intensiv të hartimit të ligjeve nëpërmjet procedurës së përsheptuar.

② Draft dokumentet në të cilat OSHC-ve u kërkohet të prezantojnë një opinion, bëhen publike. Përveç kësaj, administrata mund

të përgatisë një përmbledhje të shkurtër të shkruar në një gjuhë jo shumë teknike, e cila shpjegon pikat kryesore të dokumenteve. Ajo mund të përmbajë gjithashtu çështjet kyçe që po merren në konsideratë dhe për të cilat kërkohet të dëgjohet opinioni i OSHC-ve. Të gjitha dokumentet që lidhen me këtë, si analiza, opinione të institucioneve të tjera, etj. duhet gjithashtu të vihen në dispozicion të publikut në mënyrë që publiku të arrijë në një vendim të mirëinformuar.

③ Lista e individëve/OSHC-ve/subjekteve që kanë dhënë opinione, sëbashku me opinionet e tyre apo një përmbledhje të opinionëve të grumbulluara, bëhet publike dhe është pjesë e dërgimit të dokumentit për miratim. Përveç kësaj, edhe përgjigja mbi opinionet e dhëna bëhet gjithashtu publike, duke përfshirë shpjegime të qarta se përse disa prej opinionëve të shprehura nuk janë marrë në konsideratë. Përgjigja jepet brenda një kohe të arsyeshme pas përfundimit të procesit të konsultimit. Nuk ka ankese të shumta apo të shpeshta për mosmarrje parasysh të opinionëve të OSHC-ve.

④ Ka të dhëna mbi trajnime të nëpunësve civilë mbi këto tema. Nëpunësit civilë aplikojnë njohuritë e tyre në praktikë, siç mund të shihet përmes iniciativave të tyre dhe të qënurit të hapur ndaj përfshirjes sa më efektive të shoqërisë civile.

⑤ Shumë institucione që merren me politikën publike, kanë emëruar zyrtarë që merren praktikisht me organizimin e konsultimeve publike. Ata tregojnë se kanë njohuri dhe kuptim mbi çështjet dhe janë të hapur ndaj angazhimit të OSHC-ve, dhe ofrojnë këshillim për OSHC-të se si ato t'i përgjigjen në mënyrë sa më kuptimplotë procesit të konsultimit.

| STANDARTI 2 | INDIKATORËT |
|---|---|
| <p>Të gjitha draft politikat e ligjet janë lehtësisht të aksesueshme nga publiku në kohën e duhur.</p> | <p>Legjislacioni: 1) Legjislacioni ekzistues detyron institucionet shtetërore për të bërë publike të gjitha projektligjet dhe ligjet e politikave të miratuara, dhe përjashtimet janë përcaktuar qartë dhe në përputhje me normat ndërkombëtare dhe praktikave më të mira. 2) Ekzistojnë mekanizma dhe procedura të qarta për qasje në informacione / dokumenta me karakter publik. 3) Ekzistojnë sanksione të përshkruara qartë për nëpunësit civilë / njësitë për shkeljen e kërkesave ligjore për qasje në informacione me karakter publik.</p> <p>Praktika: 1) Institucionet publike në mënyrë aktive publikojnë projektligje dhe ligje të miratuara, vetëm nëse ato i nënshtrohen përjashtimeve të përcaktuara me ligj. 2) Institucionet publike u përgjigjen shumicës së kërkesave për qasje në informacionin publik brenda afatit të përcaktuar me ligj, në një format të qartë, japin shpjegime me shkrim mbi arsyet e refuzimit, dhe evidentojnë të drejtën e apelit dhe procedura për apelim. 3) Rastet e shkeljeve të ligjit sanksionohen.</p> |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

① Duhet të ketë një kërkesë që qeveria të publikojë dokumentat e draft ligjeve apo politikave. Nëse qytetarët apo OSHC-të nuk e dinë se çfarë ka në programin e qeverisë, nuk mund të pritët që ata të marrin një rol aktiv në procesin e vendimmarrjes. Si hap i parë, institucionet qeveritare duhet të publikojnë programin e tyre legjislativ/të politikave – një listë të temave/akteve mbi të cilat ato do të punojnë në një periudhë një vjeçare apo disa mujore. Kjo do të ndihmonte OSHC-të e interesuara të përgatiteshin dhe të viheshin në kontakt me institucionet përkatëse. Një hap i dytë është publikimi i përmbledhjes së draftit, dhe më pas i tekstit të dokumenteve të hartuara. Kjo duhet të aplikohet si për qeverinë ashtu edhe për parlamentin. Publikimi i dokumenteve nuk duhet të bazohet në kërkesat për informacion por duhet të jetë një detyrim për institucionet përkatëse.

② Legjislacioni duhet të parashikojë rregulla të qarta mbi detyrimet e autoriteteve shtetërore për ofrimin e informacionit të bazuar në kërkesa. Duhet të ketë përjashtime të limituara mbi kërkesat e përgjithshme për dhënien e

informacionit, (zakonisht lidhur me sigurinë kombëtare) subjekt i një testi të interesit publik. Kërkesat duhet të trajtohen me korrektësi dhe afatet kohore të dhënies së përgjigjeve nuk duhet të jenë shumë të gjata (zakonisht 14 ditë).

③ Nëse nuk zbatohen rregullat ligjore dhe nuk ofrohet informacioni i kërkuar, gjykata mund ta sanksionojë palën që vepron gabim. Kjo është gjithashtu e vlefshme edhe për rastet e vonësive në përgjigjet e kërkesave.

Praktika:

- ① Institucionet publikojnë përmbledhje, drafte dhe ligjet e miratuara në mënyrë proaktive. Mënyra më e thjeshtë është përdorimi i internetit – çdo institucion mund të ketë një seksion në faqen e tij elektronike ku të publikojë draft-dokumentet për konsultim. Disa vende kanë krijuar gjithashtu portale të unifikuara ku publikohen të gjitha ligjet që janë subjekt konsultimi. Këto janë faqe elektronike të specializuara ku qytetarët gjithashtu mund të postojnë opinionet e tyre online. Ligjet e miratuara gjithashtu duhet të vihen në dispozicion të publikut falas.
 - ② Nuk ka ankesa për dhunim të këtyre principeve apo ligjeve. Raportet konfirmojnë që institucionet veprojnë në përputhje me ligjet, janë të gatshëm për bashkëpunim dhe përgjithësisht janë të hapur.
 - ③ Gjykata zbaton ligjin mbi aksesin e paanshëm në informacion, dhe çdo institucion shtetëror i cili u pengon qytetarëve të drejtën e informimit sanksionohet sipas ligjit.
-

| STANDARTI 3 | INDIKATORËT |
|---|--|
| <p>Përfaqësuesit e OSHC-ve janë partnerë të barabartë në diskutime në organet ndër-sektoriale dhe zgjidhen përmes kritereve dhe një procesi të mirëpërcaktuar.</p> | <p>Legjislacioni: 1) Legjislacioni ekzistues kërkon që institucionet publike të ftojnë përfaqësuesit e OSHC-ve në organe të ndryshme të vendim-marrjes dhe / ose këshillimore të krijuara nga institucionet publike. 2) Ka udhëzime të qarta se si të sigurohet përfaqësimi i duhur nga shoqëria civile, bazuar në kritere transparente dhe të paracaktuara.</p> <p>Praktika: 1) Organet vendim-marrëse dhe këshillimore për çështjet dhe politikat që lidhen me shoqërinë civile në përgjithësi përfshijnë përfaqësuesit e OSHC-ve. 2) Përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile në këto organe kanë mundësi të paraqesin lirisht dhe të mbrojnë pozicionet e tyre, pa u sanksionuar. 3) Përfaqësuesit e OSHC-ve janë përzgjedhur përmes proceseve të drejta dhe transparente seleksionimi. 4) Pjesëmarrja në këto organe nuk i ndalon OSHC të përdorin mënyra alternative të advokacisë ose promovimin e qëndrimeve alternative të cilat nuk janë në përputhje me pozicionin e organit përkatës.</p> |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

① Kur administrata krijon organet këshillimore, ekziston një kërkesë për të përfshirë në të përfaqësues të shoqërisë civile nga fusha përkatëse për të cilën është krijuar ky organ. Përfaqësuesit e OSHC-ve janë subjekt i të njëjtave kërkesave si anëtarët e tjerë të organeve këshillimore dhe kanë të njëjtat të drejta (ata mund të votojnë, dhe nuk janë të kufizuar vetëm në statusin e vëzhguesit).

② Kur OSHC-të ftohen në organet këshillimore, kjo duhet të ndodhë përmes një procedure publike (publikohet lajmërimi për nominimet) dhe ka kritere të qarta për anëtarët. Prosesi përmes të cilit zgjidhen OSHC-të është gjithashtu transparent. Një mundësi tjetër është të lejohen OSHC-të të emërojnë vetë përfaqësuesit e tyre. Në rastin e fundit, OSHC-ve duhet t'u jepet më tepër kohë për të qenë në gjendje të organizojnë procesin e tyre të përzgjedhjes së brendshme.

Praktika:

① Praktika tregon se përfaqësuesit e OSHC-ve marrin pjesë në grupe pune dhe komitete këshillimore/konsultuese. Është e rëndësishme që në organe të tilla të marrin pjesë edhe përfaqësues nga shoqatat, fondacionet dhe kompanitë jofitimprurëse, së bashku me shoqatat e bashkive apo bizneseve që në formën e tyre ligjore janë gjithashtu OSHC. OSHC-të informohen për takimet në kohën e duhur në mënyrë që të kenë mundësi të organizohen për të ndjekur dhe përgatitur për takimin.

② Nuk duhet të ketë raste kur përfaqësues të OSHC-ve të cilët flasin në mënyrë kritike ndaj qeverisë dhe politikave të saj gjatë takimeve të këtyre organeve, të bëhen subjekt kontrolli të tepruar apo ngacmimi nga ana e shtetit. OSHC-ve u jepet kohë për të folur dhe shprehur qëndrimin e tyre, dhe për të debatuar mbi çështje gjatë debateve në organet përkatëse.

③ Nuk është e mjaftueshme të kesh përfaqësues të OSHC-ve në organet ndërsektoriale, por përfaqësuesit duhet gjithashtu të zgjidhen përmes një procedure publike e transparente. Nuk duhet të ketë shembuj të një procesi jo transparent

përzgjedhjeje. Ndonjëherë organet shtetërore mund të vendosin të ftojnë OSHC-të me të cilat ato bashkëpunojnë, por një vendim i tillë duhet të bëhet në mënyrë transparente dhe në kohën e duhur, që gjithashtu OSHC të tjera të kenë të drejtën të kërkojnë të jenë të pranishme. Autoritetet shtetërore nuk ftojnë vetëm ato OSHC të cilat janë më të përafërta me opinionet dhe tendencat e tyre.

Puna e organeve të tilla këshillimore duhet të jetë transparente. Informacioni për anëtarët, takimet dhe vendimet duhet të bëhet publik. Përveç kësaj, duhet të ekzistojë mundësia për ata që nuk janë anëtarë të këshillave konsultative që të marrin pjesë në takimet e këshillit kur diskutohen çështjet shqetësuese për organizatat e tyre.

④ Pjesëmarrja në organet ndër-sektoriale është vetëm një mënyrë për OSHC-të për të arritur misionin e tyre. Ajo nuk pengon OSHC-të të ndërmarrin masa advokuese, demonstrata, peticione apo ndonjë masë tjetër për të promovuar opinionet e tyre nëse ata e ndjejnë që ato nuk janë marrë në konsideratë apo pranuar. Përfaqësuesit e OSHC-ve duhet të jenë të aftë të komunikojnë dhe konsultohen me homologët e tyre të sektorit, sidomos ata që janë përzgjedhur si përfaqësues të tij.

Nën – fusha 3.3.: Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve

Parimi: Mjedisi është mbështetës për përfshirjen e OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve

| STANDARTI 1 | INDIKATORËT |
|--|--|
| <p>OSHC-të janë të angazhuara në shërbime të ndryshme dhe garojnë për kontrata shtetërore mbi baza të barabarta me ofruesit e tjerë</p> | <p>Legjislacioni: 1) Legjislacioni ekzistues lejon OSHC-të të ofrojnë shërbime në fusha të ndryshme si arsimit, shëndetësia, shërbimet sociale. 2) OSHC nuk kanë pengesa për të ofruar shërbime që nuk janë të përcaktuara me ligj (shërbime “shtesë”). 3) Legjislacioni ekzistues nuk rëndon me kërkesa shtesë për OSHC-të, kërkesa që nuk ekzistojnë për ofruesit e tjerë të shërbimeve.</p> <p>Praktika: 1) OSHC janë në gjendje të përfitojnë kontrata në kompeticion me ofruesit e tjerë dhe janë të angazhuar në shërbime të ndryshme (p.sh. në fushën e arsimit, shëndetit, kërkimit dhe trajnimit). 2) OSHC janë të përfshira në të gjitha fazat e zhvillimit dhe ofrimit të shërbimeve (vlerësimin e nevojave, përcaktimin e shërbimeve që adresojnë më mirë nevojat, në monitorim dhe vlerësim). 3) Në rastet kur kërkohet regjistrim / licencim, procedura për marrjen e licensës nuk është tepër e vështirë.</p> |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

① Ligji duhet të lejojë qeverinë të kontraktojë apo transferojë ofrimin e disa lloje shërbimesh tek OSHC-të. Nuk ka kufizime ligjore të OSHC-ve për të ofruar shërbime në fushat e edukimit, asistencës sociale dhe kujdesit shëndësor. Kufizimet mund të ekzistojnë për OSHC-të vetëm në fushat të cilat nuk janë tradicionalisht të konsideruara si jo-fitimprurëse (p.sh. veprimet bankare, lojrat e fatit) edhe pse OSHC-ve duhet t’u lejohej të ngrenë shoqëri tregëtare të cilat mund të punojnë në këto fusha. Nuk ka asnjë përjashtim automatik për OSHC-të nga konkurimi për ofrimin e shërbimeve nëse nuk ka arsye specifike dhe objektive për këtë.

② Ligji nuk duhet të ndalojë OSHC-të të zhvillojnë apo ofrojnë shërbime të reja edhe pse këto shërbime nuk janë të përcaktuara me ligj. Në këtë mënyrë, OSHC-të janë të afta të sjellin shërbime të reja inovatore dhe të venë në përdorim praktika të reja pilot të cilat nëse

rezultojnë të suksesshme, mundet që më vonë të adoptohen nga qeveria. Nëse shërbimet janë në fushat për të cilat kërkohet regjistrim apo licencim paraprak, kjo duhet të aplikohet gjithashtu edhe për OSHC-të (p.sh. shërbimet për fëmijët).

③ OSHC-të nuk duhet të jenë subjekt i kërkesave më të rrepta në fushat në të cilat ato ofrojnë shërbime, krahasuar me ofruesit e tjerë të këtyre shërbimeve. Standartet e cilësisë së shërbimit, subjekt i të cilave duhet të jenë edhe ofruesit, janë të njëjta si për kompanitë tregëtare, OSHC-të apo kategori të tjera ofruesish.

Praktika:

① Ekzistojnë shembuj të OSHC-ve të cilat kanë fituar kontrata për ofrimin e shërbimeve në fusha të ndryshme dhe ky nuk përbën një përjashtim. OSHC-të përbëjnë një nga kategoritë kryesore të ofruesve të shërbimeve në fushat tradicionale – asistenca sociale, kujdesi shëndetësor dhe edukimi. OSHC-të po angazhohen gjithmonë e më tepër në sipërmarrje sociale jo vetëm duke ofruar shërbime në fushat sociale por edhe duke u përfshirë në aktivitete të tjera ekonomike të cilat mbështesin misionin e tyre, përfshirë këtu edhe ofrimin e punësimit të përfituesve të tyre.

② OSHC-të janë partnerë të shtetit jo vetëm në ofrimin e shërbimeve. Shumë shpesh OSHC-të janë më pranë nevojave të njerëzve dhe mund të sjellin një vlerë të shtuar në përcaktimin e nevojave për shërbime dhe mënyrën se si ato mund të adresohen më së miri. Përveç kësaj, OSHC-të kanë ekspertizën dhe mund të ofrojnë një perspektivë tjetër në procesin e vlerësimit të shërbimeve që ofrohen nga shteti.

③ Kërkesat për regjistrimin/licensimin paraprak të ofruesve të shërbimeve në fusha të caktuara nuk duhet të largojnë ofruesit potencial të shërbimeve nga sektori i OSHC-ve për shkak të procedurave të rënduara. Procedura të tilla duhet të jenë relativisht të shpejta dhe jo të kushtueshme.

| STANDARTI 2 | INDIKATORËT |
|---|--|
| <p>Shteti është angazhuar për financimin e shërbimeve dhe financimi është i parashikueshëm dhe i vlefshëm për periudha afat-gjata.</p> | <p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Buxheti parashikon fonde për lloje të ndryshme shërbimesh të cilat mund të ofrohen nga OSHC-të, duke përfshirë këtu edhe financime disa-vjeçare. 2) Nuk ka pengesa ligjore për OSHC-të që të përfitojnë fonde publike për ofrimin e shërbimeve të ndryshme (qoftë përmes prokurimit ose nëpërmjet një forme tjetër kontraktimi apo mekanizmi të ofrimit të granteve). 3) OSHC-të mund të nënshkruajnë kontrata afatgjatë për ofrimin e shërbimeve. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) OSHC-të janë përfitues të fondeve për shërbime. 2) OSHC-të marrin fonde të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet bazë të shërbimeve të cilat janë kontraktuar të ofrojnë, duke përfshirë kosto proporcionale institucionale (kosto manaxhimi). 3) Nuk ka vonesa në pagesa dhe financimi është fleksibël me qëllim ofrimin e shërbimeve sa më cilësore. |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

① Buxheti shtetëror duhet të sigurojë mjaftueshëm burime për të lejuar financimin e shërbimeve bazë në fushat kryesore në të cilat OSHC-të veprojnë zakonisht (edukim, fusha sociale dhe kujdesi shëndetësor). Në fushën sociale, shërbimet sociale janë një mjet i rëndësishëm për përmirësimin e jetës së grupeve vulnerabël dhe nuk mund të zëvendësohen vetëm me asistencën sociale (ofrimin e ushqimit, parave apo llojeve të tjera të asistencës materiale për më të papriviligjuarit). Kuadri ligjor duhet gjithashtu të lejojë financimet shumë-vjeçare për të promovuar efektivitetin e mëtejshëm në shpërndarjen e shërbimeve dhe marrjen e rezultateve.

② OSHC-ve u lejohe të marrin pjesë në të gjitha mekanizmat përmes të cilave shteti delegon ofrimin e shërbimeve tek ofrues të jashtëm (nëpërmjet prokurimit publik, granteve, kontraktimet sociale dhe mekanizma të tjera).

③ Edhe pse në shumicën e vendeve buxheti përshtatet në baza vjetore, kompeticionet për ofruesit e shërbimeve (përfshirë OSHC-të) mbulojnë periudha më të gjata kohore dhe kontratat e nënshkruara mund të jenë afat-gjata. Në momentin që një kontratë nënshkruhet, agjencitë përkatëse shtetërore janë të detyruara

të sigurojnë fondet e nevojshme për shërbimet e kontraktuara për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës, dhe mundësisht të konsiderojnë edhe pagesën paraprake.

Praktika:

- ① Kur shteti kontraktin shërbime, ai duhet të sigurojë fonde të mjaftueshme për të mbuluar kostot bazë të shërbimeve që ata dëshirojnë të marrin (edhe pse ofruesit mund të jenë organizata jo-fitimprurëse). Në kostot e shërbimeve duhet të llogariten gjithashtu të gjitha kostot administrative dhe institucionale të lidhura me mirëmbajtjen e shërbimeve. Edhe pse OSHC-të mund të angazhojnë vullnetarë, nuk duhet të presupozohet që OSHC-të mbështeten vetëm tek vullnetarët, por ato përdorin edhe punonjësit apo konsulentë.
 - ② Të ardhurat e OSHC-ve nga ana e shtetit, për ofrimin e shërbimeve po rriten. Nuk ka ankesa që OSHC-të të jenë përjashtuar nga tenderat e shërbimeve.
 - ③ Pasi OSHC-së i është ofruar financimi, ajo duhet të lejohet t'i përdorë paratë në mënyrë të tillë që të maksimizojë impaktin dhe të përmbushë standartet përkatëse të cilësisë. Kur fondi sigurohet nën një buxhet të caktuar, OSHC-të duhet të lejohen të lëvizin para ndërmjet zërave të ndryshëm të buxhetit, për aq kohë sa zbatojnë procedurat e caktuara. Nëse fondi sigurohet në transhe, nuk duhet të ketë vonesa, dhe humbjet për shkak të këtyre vonesave duhet të kompensohen.
-

| STANDARTI 3 | INDIKATORËT |
|---|---|
| <p>Shteti ka përcaktuar qartësisht procedurat për kontraktimin e shërbimeve të cilat lejojnë përzgjedhjen transparente të ofruesve të shërbimeve, duke përfshirë edhe OSHC-të.</p> | <p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Ekziston një procedurë e qartë dhe transparente përmes të cilës financimi për shërbime është i shpërndarë ndërmjet ofruesve. 2) Çmimi nuk është kriter kryesor për zgjedhjen e ofruesit të shërbimit dhe vlera më e mirë përcaktohet si nga cilësia e shërbimit ashtu edhe një vlerësim financiar i konkurrentit. 3) Ka udhëzime të qarta se si të sigurohet transparenca dhe të shmangët konflikti i interesave. 4) Ekziston e drejta për të të apeluar kundër rezultateve të kompeticionit. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Shumë shërbime u janë kontraktuar OSHC-ve. 2) Kompeticionet konsiderohen të drejta dhe janë shmangur konfliktet e interesit. 3) Zyrtarët shtetërorë kanë kapacitet të mjaftueshëm për të organizuar procedurat. |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

- ① Përzgjedhja e ofruesve të shërbimeve kryhet nëpërmjet një kompeticioni të hapur ku lejohet të marrin pjesë të gjithë ofruesit e ligjshëm. Kriteret e vlerësimit bëhen publike paraprakisht.
- ② Në fusha të caktuara të ofrimit të shërbimeve, p.sh. fushat sociale, kriteri kryesor për vlerësimin e ofertave duhet të jetë eksperiencia e ofruesit dhe e stafit që do të ofrojë shërbimin. Në këtë fushë, është e rëndësishme të ofrohet cilësia më e mirë e mundshme apo t'u shërbehet një numri sa më të madh njerëzish për buxhetin që ka shteti, në vend që të kursehet nga buxheti ekzistues. Në fusha të tilla, ofertat financiare nuk duhet të jenë kriteret më të rëndësishme.
- ③ Vlerësuesit e ofertave duhet të deklarojnë paraprakisht çdo konflikt interesi në proces. Të gjitha procedurat për përzgjedhjen e ofruesve të shërbimeve janë publike, në linjë me praktikën e mira rregullatore mbi shpërndarjen e fondeve siç përshkruhet më lart.

Kuadri ligjor duhet të lejojë apelimin përpara një entiteti të pavarur, dhe më pas në gjykatë.

Praktika:

- ① Ekzistojnë shembuj të mjaftueshëm të OSHC-ve që kontraktohen nga shteti për ofrimin e shërbimeve në fusha të ndryshme. Në fushat tradicionale ku punojnë OSHC-të, kontraktimet të tilla janë praktika të zakonshme, dhe OSHC-të (shoqatat, fondacionet dhe kompanitë jo-fitimprurëse) njihen si kontraktorë të rëndësishëm të shtetit.
- ② Thirrjet për ofruesit e shërbimeve nuk janë vetëm formale dhe nuk janë të përshtatura vetëm për një organizatë specifike. Nuk ka raste në të cilat procedurat të jenë dukur transparente fillimisht, por më pas kontratat janë fituar nga organizata që kanë lidhje me organizatorët. Ofrohen shpjegime mbi deklaratat e konfliktit të interesit nëse kërkohet një gjë e tillë.
- ③ Zyrtarët shtetërorë përkatës janë të familjarizuar me procedurat përmes të cilave OSHC-të mund të kontraktohen për të ofruar shërbime dhe nuk kanë probleme teknike në organizimin e kompeticioneve. Nuk ka raste që autoritetet të vendosin të mos transferojnë ofrimin e shërbimeve për shkak se nuk janë të sigurtë mbi procedurën që duhet të përdorin dhe janë të shqetësuar se institucionet mbikqyrëse mund t'i sanksionojnë. Si një praktikë e mirë, nëpunësit civilë trajnohen për të ndërmarrë procese të tilla.

| STANDARTI 4 | INDIKATORËT |
|--|--|
| <p>Ekziston një sistem të qartë përgjegjësie, monitorimi dhe vlerësimi të ofrimit të shërbimeve</p> | <p>Legjislacioni: 1) Ekziston mundësia ligjore për monitorimin si të shpenzimeve ashtu edhe të cilësinë së ofruesve të shërbimeve. 2) Ekzistojnë standarde të qarta të cilësisë dhe procedura të monitorimit për shërbimet.</p> <p>Praktika: 1) OSHC nuk janë subjekt i kontrollit të tepruar. 2) Monitorimi kryet mbi një baza të rregullta, sipas procedurave dhe kriterëve të paranoftuara.. 3) Kryhet vlerësim i rregullt i cilësisë dhe efekteve / impaktit të shërbimeve të ofruara dhe ky vlerësim është në dispozicion të publikut.</p> |

SHPJEGIMI

Legjislacioni:

① Ofruesit e shërbimeve duhet të monitorohen si për cilësinë e shërbimeve që ata ofrojnë ashtu edhe për shpenzimet e kryera për ofrimin e këtyre shërbimeve. Monitoruesit duhet të kenë të drejtën të inspektojnë ambjentet në të cilat ofrohet shërbimi, bazuar në njoftime paraprake.

② Monitorimi bazohet në standarde dhe kriterë të qarta. Për llojet kryesore të shërbimeve, ekzistojnë një minimum standartesh të cilësisë që duhet të zbatohen nga ofruesit. Informacioni mbi kontratat e akorduara, aktivitetet e kryera dhe numri i njerëzve të cilëve u shërbehet, bëhet publik.

Praktika:

① OSHC-të nuk janë subjekt i kontrollit të tepruar, krahasuar me ofruesit e tjerë. Kur realizohen kontrole të brendshme, ato paraprihen nga njoftimet të cilat tregojnë qartë synimin dhe kohëzgjatjen e vizitës.

② OSHC-të e kanë të qartë se për çfarë dhe kujt duhet t'i raportojnë. Ato monitorohen rregullisht.

③ Institucionet shtetërore bëjnë një vlerësim të rregullt të shërbimeve që ofrohen dhe impaktin e tyre. Rezultatet e vlerësimeve të tilla bëhen publike dhe përdoren për të formësuar politikat e qeverisë në fushën përkatëse.

Si të përdoret Matrica

Matrica monitoruese përmban standarde mbi të cilat është rënë dakort që janë standartet e përbashkëta të nevojshme për të siguruar ekzistencën e një mjedisi mundësues optimal për zhvillimin e shoqërisë civile. Matrica është hartuar nga praktikantët e OSHC-ve dhe nga ekspertët e organizatave anëtare dhe partnere të BCSDN, kryesisht si një mjet monitorimi i OSHC-ve për zhvillimin e shoqërisë civile. Megjithatë, me adaptimin e metodologjive të përshtatshme, Matrica mund të frymëzojë dhe promovojë zhvillimin e mjeteve të vetë-vlerësimit për zyrtarët shtetërorë dhe mjete monitorimi nga donatorë të ndryshëm. Pavarësisht nga kjo, në seksionin vijues do të nënvizohen vetëm mënyrat se si kjo Matricë mund të përdoret nga OSHC-të.

Matrica është një mjet i ri, i freskët që është hartuar për **OSHC-të që tashmë janë duke ndjekur mjedisin mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile** apo nën-fushave të tij, të cilat janë të interesuara në një përjasje më gjithëpërfshirëse në monitorimin dhe advokacinë mbi mjedisin mundësues në vendin e tyre. Nëpërmjet ngritjes mbi një standard tashmë ekzistues ndërkombëtar, rajonal apo kombëtar (në (nën) fushat ku ato ekzistojnë) dhe praktikave më të mira rregullatore, Matrica përbën një mjet të lehtë për t'u përdorur nga çdo OSHC e interesuar në një mjet monitorimi tashmë ekzistues të mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile në tërësi, apo një pjesë të tij. Gjatë zhvillimit të saj, i është dhënë konsideratë hartimit të indikatorëve që mund të monitorohen përmes informacionit dhe të dhënave dytësore, duke kërkuar kështu një minimum pune studimore parësore, dhe duke reduktuar nevojën për angazhime financiare apo ekspertizë specifike në mbledhje të dhënash. Së fundi, duke qënë se kjo është përpjekja e parë për të ndërtuar një mekanizëm monitorimi për një fushë komplekse e gjithëpërfshirëse siç është ajo e zhvillimit të shoqërisë civile, Paketa shpjeguese në fazën e saj fillestare ofron vetëm udhëzime bazë se si duhet të përdoret Matrica dhe se si duhet të kryhet monitorimi. Synimi është të rishikohet si Matrica ashtu edhe metodologjia monitoruese pas një periudhe "prove" një-vjeçare.

Gjerësisht, janë parë katër hapa në mënyrën se si të aplikohet dhe përdoret Matrica:

HAPI 1



Përshtatja e matricës me situatën e vendit

Në mënyrë që të jenë gati për monitorim, nën-fushat, duke përfshirë edhe parimet, standartet dhe indikatorët e dhënë (legjislativi dhe praktika), kanë nevojë që të rishikohen dhe përshtaten kundrejt terrenit ligjor dhe situatës faktike të vendit përkatës. Mund të ndodhë që një fushë të mos jetë e **rregulluar** me ligj, të mos jetë e rëndësishme apo për arsye të ndryshme OSHC-të vendosin të mos e mbulojë atë si pjesë e monitorimit. Mund të ketë gjithashtu edhe raste që në vende të ndryshme mund të mos ekzistojnë të dhënat dytësore për të kontrolluar indikatorët e për të aplikuar kështu nën-fushën.

Situata e një vendi të caktuar duhet të përcaktojë nëse ekspertiza e një organizate apo një grupi ekspertësh të sektorit të OSHC-ve është e mjaftueshme për të përshtatur dhe bërë të vlefshme Matricën për këtë vend, apo nëse situata kërkon një përjasje konsultative përmes së cilës Matrica të përshtatet dhe të bëhet e vlefshme përmes një (serie) takimesh konsultuese me OSHC-të dhe/ose aktorët e përfshirë.

HAPI 2



Monitorimi i bazës fillestare

Pasi Matrica është përshtatur dhe bërë e vlefshme, **mund të fillojë monitorimi i parë**, fillestar. Duke qënë se Matrica është e hartuar në mënyrë të tillë që të sigurojë një mekanizëm për një monitorim afatgjatë/të vazhdueshëm, intervalet e monitorimit është mirë të vendosen në baza vjetore. Kjo është gjithashtu një mënyrë për të siguruar që të dhënat e monitoruese mund të ushqejnë (dhe përdoren) indekset globale dhe rajonale ekzistuese të monitorimit, në fushat tematike të caktuara të zhvillimit të shoqërisë civile, ose anasjelltas. Megjithatë, në vitin fillestar, viti 0, është i dobishëm krijimi i një baze monitorimi paraprake brenda disa muajve (p.sh. 6 muaj) pas përshtatjes dhe fillimit të monitorimit. Hapi i dytë do të jetë testimi i monitorimit të përshtatur kundrejt të dhënave

të disponueshme, eksperiencës së OSHC-ve që udhëheqin monitorimin, si edhe ekspertizës që gjendet në sektorin e gjerë. Ky **monitorim i bazës fillestare** mund të prezantohet dhe kontrollohet me një fokus grup të OSHC-ve dhe/ose aktorëve të tjerë të përfshirë, për të rregulluar indikatorët sipas të dhënave dhe ekspertizës së disponueshme, nëse një gjë e tillë do të jetë e nevojshme.

HAPI 3



Zbatimi (konsultimi/përjasja e ekspertëve)

Ashtu si edhe vetë përshtatja, rrethanat dhe terreni specifik i vendit duhet të diktojnë nëse monitorimi duhet kryer nëpërmjet konsultimeve (tematike sipas nën-fushave, rajonale, etj.) apo nëpërmjet ekipeve/paneleve të ekspertëve. Ajo që është jashtëzakonisht e rëndësishme për t'u marrë në konsideratë në zgjedhjen e përjasjes është **vlefshmëria dhe legjitimiteti** i gjetjeve që do të zhvillohen në fund. Kjo është e vetmja mënyrë për të siguruar që Matrica të mos përbëjë thjesht një pjesë të punës kërkimore mbi sektorin e shoqërisë civile, por një mjet që përcakton axhendat dhe prioritetet e përbashkëta dhe frymëzon veprime dhe përmirësime në drejtim të avancimit të mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile në një vend të caktuar.

HAPI 4



Advokacia

Së fundi, **rezultatet e monitorimit vjetor/periodik**, më së miri të prezantuara në formën e një dokumenti apo përmbledhjeje politikash, duhet të hartohen dhe t'i prezantohen komunitetit të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë të përfshirë. Kjo mund të ndodhë në nivel kombëtar, ose nëpërmjet një serie aktiviteteve tematike lokale. Synimi është të përmbledhet puna e bërë në periudhën e shkuar, të identifikohen boshllëqet (si legjislativë ashtu edhe praktike) dhe të propozohen aksione të mundshme për të përmirësuar situatën.

Aneks.

Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

| PARIMI | STANDARTET/ HAPAT E MATJES SE PROGRESIT | INDIKATORËT | INDEKSE RELEVANTE GLOBALE APO RAJONALE |
|--|---|--|---|
| Fusha 1: Garancitë themelore juridike të lirive | | | |
| Nën-fusha 1.1.: Liria e organizimit | | | |
| Liria e organizimit është e garantuar dhe ushtrohet lirish nga të gjithë | 1. Të gjithë individët dhe subjektet juridike mund të krijojnë dhe të marrin pjesë lirish në organizata joformale dhe/ose të regjistruara, offline dhe online. | <p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Ekziston një kuadër ligjor sipas të cilit çdo person mund të krijojë shoqata, fondacione dhe lloje të tjera subjektsh jo-fitimprurëse, jo-qeveritare (p.sh. kompani jo-fitimprurëse) për çfarëdo qëllimi. 2) Kuadri ligjor lejon si personat juridikë dhe individët të ushtrojnë këtë të drejtë pa diskriminim (moshe, kombësie, kapaciteti ligjor, gjinie etj). 3) Regjistrimi nuk është i detyrueshëm, dhe në rastet kur organizatat vendosin të regjistrohen, rregullat e regjistrimit janë të përcaktuara në mënyrë të qartë që të lejojnë një proces regjistrimi dhe apelimi të lehtë, jo shumë të gjatë në kohë dhe të pakushtueshëm. 4) Ligji lejon për krijimin e rrjeteve midis organizatave në vendet e tyre dhe jashtë, pa njoftim paraprak. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Çdo person fizik apo juridik në praktikë mund të formojë shoqata, fondacione apo forma të tjera organizimesh jo-fitimprurëse, jo-qeveritare offline apo online. 2) Personat fizikë dhe juridikë nuk sanksionohen për mos-regjistrimin e organizatave të tyre. 3) Regjistrimi është me të vërtetë i arritshëm brenda afateve të përcaktuara me ligj; autoritetet vendosin mbi rastet në mënyrë jo-subjektive dhe apolitike. 4) Individët dhe OSHC-të mund të formojnë dhe të marrin pjesë në rrjete dhe koalicione, brenda dhe jashtë vendeve të tyre. | <p>NGO Sustainability Index for Central and Eastern Europe and Euroasia , USAID (http://transition.usaid.gov/locations/europe_eurasia/dem_gov/ngoindex/)</p> <p>ICNL NGO Law Monitor (http://www.icnl.org/research/monitor/index.html)</p> <p>United States International Grantmaking (USIG) (http://www.usig.org/countryinfo.asp)</p> <p>EU Progress Report (http://ec.europa.eu/enlargement/how-does-it-work/progress-reports/index_en.htm)</p> <p>Freedom House (www.freedomhouse.org)</p> <p>Democracy Index (https://www.eiu.com)</p> <p>Freedom Meta Index (http://www.freeexistence.org)</p> <p>Human Development Index (http://hdr.undp.org/en/humandev/hdi/)</p> <p>Social Development Index (http://www.indsocdev.org/)</p> <p>Civic Engagement Index (http://www.oecdbetterlifeindex.org/topics/civic-engagement/)</p> <p>Charity Commission NGO Sector&Regulation Review Tool (http://www.ngoregnet.org/whats-new/NGO_Sector_and_Regulation_Review_Tool.asp)</p> <p>Nations in Transit (www.freedomhouse.org/report-types/nations-transit)</p> <p>Polity IV Project (http://www.systemicpeace.org)</p> <p>Civil Society Index (https://www.civicus.org/csi/)</p> <p>Global Corruption Barometer (www.transparency.org/research/gcb/overview)</p> <p>Index of Economic Freedom (http://www.heritage.org)</p> <p>Doing Business In Index (http://www.doingbusiness.org)</p> |
| | 2. OSHC-të veprojnë lirish, pa ndërhyrje të pajustificuara të shtetit në në qeverisje e tyre të brendshme dhe aktivitete | <p>Legislation:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Kuadri ligjor ofron garanci kundër ndërhyrjes së shtetit në çështjet e brendshme të shoqatave, fondacioneve apo llojeve të tjera të subjekteve jo-fitimprurëse. 2) Shteti siguron mbrojtje nga ndërhyrje të palëve të treta. 3) Raportimi financiar (duke përfshirë rregulloret e pastrimit të parave) dhe rregullat e kontabilitetit konsideron natyrën specifike të OSHC-ve dhe janë në proporcion me madhësinë e organizatës dhe llojin / qëllimin e aktiviteteve të saj. 4) Sanksionet për shkeljen e kërkesave ligjore duhet të bazohen në legjislacionin në fuqi dhe të ndjekin parimin e proporcionalitetit. 5) Kufizimet dhe rregullat për shpërbërjen dhe mbylljen plotësojnë standartet e ligjeve ndërkombëtare dhe janë të bazuara në kritere objektive të cilat kufizojnë vendimmarrjen arbitrare. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Nuk ka raste të ndërhyrjes shtetërore në çështjet e brendshme të shoqatave, fondacioneve apo llojeve të tjera të subjekteve jo-fitimprurëse. 2) Nuk ka praktika të mbikëqyrjeve okupuese të cilat të imponojnë kërkesa të rënduara raportimi. 3) Sanksione aplikohen në raste të rralla / ekstreme, ato janë proporcionale dhe janë subjekt i një shqyrtimi gjyqësor. | |

| PARIMI | STANDARTET/ HAPAT E MATJES SE PROGRESIT | INDIKATORËT | INDEKSE RELEVANTE GLOBALE APO RAJONALE |
|---|--|---|---|
| Liria e organizimit është e garantuar dhe ushtrohet lirisht nga të gjithë | 3. OSHC-të mund të kërkojnë dhe sigurojnë lirisht nga burime të ndryshme vendase dhe të huaja, burime financiare për të mbështetur aktivitetet e tyre | Legjislacioni: 1) Legjislacioni lejon OShC-të të angazhohen në aktivitete ekonomike. 2) OshC-të lejohen të marrin fonde të huaja. 3) OshC-të lejohen të marrin fonde nga individët, korporatat dhe burime të tjera. Praktika: 1) Legjislacioni për OSHC-të që angazhohen në aktivitete ekonomike zbatohet dhe nuk përbën barrë për OSHC-të. 2) Nuk ka kufizime (p.sh. barrë administrative ose financiare, pre-miratim, apo kanalizim të fondeve të tilla nëpërmjet organeve të veçanta) për OSHC-të për të marrë fonde të huaja. 3) Marrja e financimit nga individët, korporatat dhe burime të tjera është e lehtë, efektive dhe pa ndonjë kosto të panevojshme apo barrë administrative. | |
| Nën-fusha 1.2.: Liritë e tjera | | | |
| Liritë e organizimit dhe të shprehjes janë të garantuara për të gjithë | 1. Përfaqësuesit e OSHC-ve, individualisht ose nëpërmjet organizatës së tyre, gëzojnë lirinë e organizimit paqësor | Legjislacioni: 1) Kuadri ligjor është i bazuar në standardet ndërkombëtare dhe siguron të drejtën e lirisë së organizimit për të gjithë pa asnjë diskriminim. 2) Ligjet i njohin dhe nuk i kufizojnë mbledhjet spontane, simultane . 3) Ushtrimi i së drejtës nuk është subjekt për autorizim paraprak nga autoritetet, por më e shumta për një procedurë njoftimi paraprak, e cila nuk është e rëndë. 4) Çdo kufizim i së drejtës bazuar në ligj dhe lëshuar nga autoriteti rregullator mund të apelohej nga organizatorët. Praktika: 1) Nuk ka raste të shkeljes së lirisë së tubimit, dhe çdo grup njerëzish mund të mbledhet në vendin dhe kohën e dëshiruar, në përputhje me dispozitat ligjore. 2) Kufizimet janë të justifikuara me shpjegimin e arsyes për çdo kufizim, i cili i komunikohet menjëherë me shkrim organizatorit për të garantuar mundësinë e apelimit. 3) Mbledhjet simultane, spontane mund të kryhen, dhe shteti lehtëson dhe mbron grupet për të ushtruar të drejtën e tyre kundër njerëzve të cilët synojnë për të parandaluar ose prishur mbledhjen. 4) Ka raste të lirisë së mbledhjes të praktikuar nga OSHC-të (individualisht ose nëpërmjet organizatave të tyre) pa autorizim paraprak, kur njoftimi nevojitet ai dorëzohet në një periudhë të shkurtër kohe dhe nuk kufizon mundësinë për të organizuar mbledhjen. 5) Nuk ka përdorim të tepruar të forcës të ushtruar nga organet e zbatimit të ligjit, duke përfshirë këtu edhe ndalimin apo dënimin e organizatorëve dhe pjesëmarrësve. 6) Media duhet të ketë qasje sa më të madhe nëpër mbledhje. | NGO Sustainability Index for Central and Eastern Europe and Euroasia, USAID (http://transition.usaid.gov/location/europe_eurasia/dem_gov/ngoin dex/) ICNL NGO Law Monitor (http://www.icnl.org/research/monitor/index.html) World Press Freedom Index (http://en.rsf.org) Media Sustainability Index (www.irex.org/msi) |
| | 2. Përfaqësuesit e OSHC-ve, individualisht ose nëpërmjet organizatës së tyre, gëzojnë lirinë e shprehjes | Legjislacioni: 1) Korniza ligjore siguron lirinë e shprehjes për të gjithë. 2) Kufizimet, të tilla si kufizime të të folurit me urretje, të imponuara nga legjislacioni janë të përshkruara qartë dhe në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. 3) Shpifja përbën më tepër një kundravajtje se sa pjesë e kodit penal. Praktika: 1) Përfaqësuesit e OShC, sidomos organizatave për të drejtat e njeriut dhe watch dog, gëzojnë të drejtën e lirisë | |

| PARIMI | STANDARTET/ HAPAT E MATJES SE PROGRESIT | INDIKATORËT | INDEKSE RELEVANTE GLOBALE APO RAJONALE |
|---|--|---|---|
| Liritë e organizimit dhe të shprehjes janë të garantuara për të gjithë | | së shprehjes në çështje që ata mbështesin dhe ndaj të cilave janë kritikë. 2) Nuk ka raste të shkeljes së të drejtës së lirisë së shprehjes për të gjithë. 3) Nuk ka raste ku individë, duke përfshirë përfaqësues të OSHC-ve do të persekutoheshin për fjalime kritike, në publik apo private. 4) Nuk ka asnjë sanksion për fjalimin kritik, në publik apo privat, sipas kodit penal. | |
| | 3. Përfaqësuesit e OSHC-ve, individualisht ose nëpërmjet organizatës së tyre, kanë të drejtë të marrin dhe përçojnë informacion nëpërmjet çdo media | Legjislacioni: 1) Kuadri ligjor ofron mundësinë për të komunikuar nëpërmjet dhe për të patur akses në çfarëdo burim informacioni, duke përfshirë Internetin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK); nëse ka kufizime ligjore këto janë të rralla, të kufizuara dhe në bazë të ligjeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. 2) Kuadri ligjor ndalon monitorimin pajustificuar të kanaleve të komunikimit, duke përfshirë Internetin dhe TIK, ose mbledhjen e informacionit të përdoruesit nga ana e autoriteteve. Praktika: 1) Nuk ka raste në praktikë, ku janë vendosur kufizime mbi qasjen e çfarëdo burimi informacioni, përfshirë internetin apo TIK. 2) Interneti është gjerësisht i arritshëm dhe i përballeshëm. 3) Nuk ka asnjë praktikë apo raste monitorimi të pajustificuar nga ana e autoriteteve, të kanaleve të komunikimit duke përfshirë internetin apo TIK, ose mbledhjes së informacionit të përdoruesit. 4) Nuk ka raste të ngacmimit të anëtarëve të grupeve të rrjeteve sociale nga ana e policisë. | |
| Fusha 2: Kuadri për qëndrueshmërinë dhe lehtësirat financiare për OJF-të | | | |
| Nën-fusha 2.1: Trajtimi tatimor/fiskal për OJF-të dhe donatorët e tyre | | | |
| OSHC-të dhe donatorët gëzojnë trajtim të favorshëm tatimor | 1. Ka përfitime tatimore për disa burime të ardhurash për OSHC-të | Legjislacioni: 1) Ligji parashikon trajtim tatimor falas për të gjithë grantet dhe donacionet që mbështesin aktivitetin jo-fitimprurës të OSHC-ve. 2) Ligji siguron përfitime tatimore për aktivitetet ekonomike të OSHC-ve. 3) Ligji siguron përfitime tatimore për investimet pasive të OSHC-ve. 4) Ligji lejon krijimin dhe siguron përfitime tatimore për Dhurimet e Kushtëzuara (endowments). Praktika: 1) Nuk është raportuar asnjë taksë mbi grantet direkte ose indirekte (e fshehur). 2) Përfitimet tatimore për aktivitetet ekonomike të OSHC-ve janë efektive dhe mbështesin funksionimin e OSHC-ve. 3) Investimet pasive janë shfrytëzuar nga OSHC-të dhe nuk janë aplikuar sanksione për të tilla investime. 4) Dhurimet e kushtëzuara që mundësojnë gjenerimin e të ardhurave (endowments) janë krijuar pa vështirësi të mëdha procedurale dhe veprojnë lirish, pa ndonjë barrë administrative apo kosto të lartë financiare. | NGO Sustainability Index for Central and Eastern Europe and Euroasia, USAID (http://transition.usaid.gov/location/europe_eurasia/dem_gov/ngoin dex/) ICNL NGO Law Monitor (http://www.icnl.org/research/monitor/index.html) United States International Grant making (USIG) (http://www.usig.org/countryinfo.asp) Index of Economic Freedom (http://www.heritage.org/index/ab out) Economic Freedom of the World Index (http://www.freetheworld.com/index.html) Global Giving Index (https://www.cafonline.org/publications/2011-publications/world- |

| PARIMI | STANDARTET/ HAPAT E MATJES SE PROGRESIT | INDIKATORËT | INDEKSE RELEVANTE GLOBALE APO RAJONALE |
|--|--|---|--|
| OSHC-të dhe donatorët gëzojnë trajtim të favorshëm tatimor | 2. Janë ofruar lehtësira fiskale për të nxitur dhurimet nga individët dhe korporatat. | <p>Legjislacioni:</p> <p>1) Ligji parashikon zbritje nga taksat për dhurime individuale apo nga korporatat për OSHC-të.</p> <p>2) Ka kërkesa/ kushte të qarta për marrjen e dhurimeve për të cilat ka ulje nga taksat dhe këto përfshijnë një gamë të gjerë aktivitetesh në dobi të publikut.</p> <p>3) Politikat shtetërore në lidhje me përgjegjshmërinë sociale (CSR) marrin në konsideratë nevojat e OSHC-ve dhe i përfshijnë ato në programet e tyre.</p> <p>Praktika:</p> <p>1) Ekziston një procedurë funksionale për të kërkuar zbritje taksash për dhurime individuale apo të korporatave.</p> <p>2) Organizatat e Shoqërisë Civile janë partnerë me shtetin në promovimin e CSR.</p> <p>3) OSHC-të që punojnë në fushat kryesore të interesit publik, duke përfshirë të drejtat e njeriut dhe organizatat mbikëqyrëse, në mënyrë efektive përfitojnë dhurime për të cilat aplikohet ulje taksash.</p> | giving-index-2011.aspx |
| Nën-fusha 2.2.: Mbështetja nga shteti | | | |
| Mbështetja e shtetit për OSHC-të ofrohet në mënyrë transparente dhe shpenzohet në mënyrë të përgjegjshme | 1. Ka financim publik në dispozicion për zhvillimin institucional të OSHC-ve, mbështetje projekti dhe bashkë-financim të granteve të BE-së dhe të tjera | <p>Legjislacioni:</p> <p>1) Ka një ligj apo politikë kombëtare (dokument), që rregullon mbështetjen shtetërore për zhvillimin institucional të OShC-ve, mbështetje për projektet dhe bashkë-financimin e projekteve të financuara nga BE.</p> <p>2) Ekziston një mekanizëm në nivel kombëtar për shpërndarjen e fondeve publike për OShC-të.</p> <p>3) Fondet publike për OShC-të janë planifikuar në mënyrë të qartë në buxhetin e shtetit.</p> <p>4) Ka procedura të qarta për pjesëmarrjen e OSHC-ve në të gjitha fazat e ciklit të financimit publik.</p> <p>Praktika:</p> <p>1) Fondet publike në dispozicion u përgjigjen nevojave të sektorit të OSHC-ve.</p> <p>2) Ekzistojnë organe qeveritare me një mandat të qartë për shpërndarjen dhe / ose monitorimin e shpërndarjes së fondeve shtetërore.</p> <p>3) Financimi është i parashikueshëm, jo i prerë në mënyrë drastike nga njëri vit në tjetrin, dhe shuma e buxhetit për OSHC është lehtësisht e identifikueshme.</p> <p>4) Pjesëmarrja e OShC-ve në ciklin e financimit publik është transparente dhe kuptimplotë.</p> | <p>NGO Sustainability Index for Central and Eastern Europe and Euroasia, USAID http://transition.usaid.gov/locations/europe_eurasia/dem_gov/ngoindex</p> <p>Transparency International http://www.transparency.org</p> <p>Corruption Perception Index http://cpi.transparency.org/cpi2011/results/</p> <p>Global Giving Index https://www.cafonline.org/publications/2011-publications/world-giving-index-2011.aspx</p> <p>Global Integrity Report http://www.globalintegrity.org/report</p> |
| | 2. Financimi publik shpërndahet në një mënyrë të përcaktuar dhe transparente | <p>Legjislacioni:</p> <p>1) Procedura për shpërndarjen e fondeve publike është transparente dhe ligjërishit detyruese për palët.</p> <p>2) Kriteret për përzgjedhje janë të qarta dhe të publikuara paraprakisht.</p> <p>3) Ekzistojnë procedura të qarta që adresojnë çështjet e konfliktit të interesit në vendimmarrje.</p> <p>Praktika:</p> <p>1) Informacione lidhur me procedurat për financim dhe informacioni mbi projektet e financuara është në</p> | |

| PARIMI | STANDARTET/ HAPAT E MATJES SE PROGRESIT | INDIKATORËT | INDEKSE RELEVANTE GLOBALE APO RAJONALE |
|---|--|--|---|
| Mbështetja e shtetit për OSHC-të ofrohet në mënyrë transparente dhe shpenzohet në mënyrë të përgjegjshme | | dispozicion të publikut. 2) Organet shtetërore ndjekin procedurën dhe e aplikojnë atë në një mënyrë të harmonizuar. 3) Kërkesat e aplikimit nuk përbëjnë barrë për OSHC-të. 4) Vendimet mbi tenderat konsiderohen të drejta dhe konfliktet e interesit janë shpallur paraprakisht. | |
| | 3. Ekziston një sistem i qartë për llogaridhënien, monitorimin dhe vlerësimin e fondeve publike | Legjislacioni: 1) Procedura për shpërndarjen e fondeve publike parashikon masa të qarta për llogaridhënien, monitorimin dhe vlerësimin e tyre. 2) Ka sanksione për OSHC-të që keqpërdorin fondet dhe ato janë në proporcion me shkeljen e procedurës. Praktika: 1) Monitorimi kryhet vazhdimisht dhe në përputhje me indikatorët objektivë dhe të paracaktuar. 2) Vlerësimi i rregullt i efekteve / impaktit të fondeve publike kryhet nga organet shtetërore dhe është në dispozicion të publikut. | |
| | 4. Ekziston mbështetje jo-financiare nga shteti | Legjislacioni: 1) Legjislacioni lejon autoritetet shtetërore të alokojnë mbështetje jo-financiare, si psh. pronë shtetërore, marrje me qera të hapësirës pa kompensim financiar (kohor), trajnime, konsultime dhe burime të tjera falas për OSHC-të. 2) Mbështetja jo-financiare ofrohet në bazë të proceseve të përcaktuara në mënyrë të qartë, duke u bazuar në kritere objektive dhe pa privilegjuar asnjë grup. Praktika: 1) OSHCpërdorin mbështetje jo-financiare nga shteti. 2) OSHCtrajtohen në mënyrë të barabartë ose përfitojnë më shumë mbështetje në krahasim me aktorët e tjerë, kur ofrojnë burime jo-financiare shtetërore. 3) Nuk ka raste të autoriteteve shtetërore që ofrojnë mbështetje jo-financiare vetëm për OSHC-të që nuk kritikojnë punën e tyre; ose e rasteve të privimit të mbështetjes për OSHC-të kritike; ose diskriminim tjetër bazuar në besnikërinë, përkatësinë politike ose terma të tjera të paligjshme. | |
| Nën-fusha 2.3: Burimet njerëzore | | | |
| Politikat shtetërore dhe mjedisi ligjor stimulojnë dhe lehtësojnë punësimin, vullnetarizmin dhe angazhime të tjera me OSHC-të | 1. OSHC-të trajtohen në mënyrë të barabartë me punëdhënës të tjerë | Legjislacioni: 1) OSHCtrajtohen në mënyrë të barabartë me punëdhënës të tjerë me ligj dhe politika. Praktika: 1) Nëse ka programe shtetërore për nxitje punësimi, OSHC-të trajtohen njësoj si të gjithë sektorët e tjerë. 2) Ka statistika të rregullta mbi numrin e të punësuarve në sektorin jo-fitimprurës. | World Economic Forum Global Competitiveness Report (http://www.weforum.org/issues/global-competitiveness) Global Employment Trends (http://www.ilo.org/global/research/global-reports/global-employment-trends/WCMS_171571/lang-en/index.htm) World Economic Forum Global Gender Gap (http://reports.weforum.org/global-gender-gap-2011/) Civic Engagement Index (http://www.oecdbetterlifeindex.org/topics/civic-engagement/) Global Giving Index (https://www.cafonline.org/publications/2011-publications/world-giving-index-2011.aspx) |
| | 2. Ekzistojnë politika dhe ligje që mundësojnë vullnetarizmin | Legjislacioni: 1) Legjislacioni stimulon vullnetarizmin dhe përfshin praktikën më të mira rregullative, duke lejuar në të njëjtën kohë për praktika spontane vullnetarizmi. 2) Ekzistojnë stimuj dhe programe të mbështetura nga shteti për zhvillimin dhe promovimin e vullnetarizmit. 3) Ekzistojnë marrëdhënie kontraktuale të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe mbrojtje për vullnetarizmin e organizuar. Praktika: 1) Nxitjet dhe programet janë transparente dhe lehtësisht të disponueshme nga OSHC-të dhe politika / dokumenti strategjik / ligji zbatohet plotësisht, monitorohet dhe vlerësohet periodikisht në mënyrë pjesëmarrëse. 2) Procedurat administrative për organizatorët e | |

| PARIMI | STANDARTET/ HAPAT E MATJES SE PROGRESIT | INDIKATORËT | INDEKSE RELEVANTE GLOBALE APO RAJONALE |
|---|--|--|--|
| Politikat shtetërore dhe mjedisi ligjor stimulojnë dhe lehtësojnë punësimin, vullnetarizmin dhe angazhime të tjera me OSHC-të | | aktivitetete vullnetare ose vullnetarëve nuk janë të komplikuara dhe janë pa ndonjë kosto të panevojshme. 3) Vullnetarizmi mund të bëhet në çfarëdo forme, nuk ka raste ankesash mbi kufizimeve ndaj vullnetarizmit. | *Several other reports can be consulted, such as: World of Work Report, Youth Employment, Global Wage Report, World Social Security Report |
| | 3. Sistemi arsimor promovon angazhimin qytetar | Legjislacioni: 1) Arsimi joformal promovohet nëpërmjet politikave strategjive /ligjeve. 2) Subjekte të lidhura me shoqërinë civile janë të përfshira në programin zyrtar në të gjitha nivelet e sistemit arsimor. Praktika: 1) Sistemi arsimor përfshin mundësi për angazhim qytetar në OShC. 2) Ofrimi i arsimit jo-formal nga OShC-të njihet. | |
| Fusha 3: Marrëdhënia Qeveri-OSHC | | | |
| Nën-fusha 3.1.: Kuadri dhe praktikat për bashkëpunim | | | |
| Ekziston një qasje strategjike për të çuar më tej bashkëpunimin shtet-OSHC dhe zhvillimin e OSHC-ve | 1. Shteti njih, përmes politikave dhe strategjive, rëndësinë e zhvillimit të sektorit dhe bashkëpunimit me të | Legjislacioni: 1) Ekzistojnë dokumenta strategjikë që kanë të bëjnë me marrëdhëniet shtet-OSHC dhe zhvillimin e shoqërisë civile. 2) Dokumenti strategjik përfshin qëllimet dhe masat si dhe financimin në dispozicion dhe ndarje të qartë të përgjegjësive (plane veprimi përfshirë indikatorët). 3) Dokumenti strategjik përfshin masa që janë zhvilluar në konsultim me dhe / ose të rekomanduara nga OSHC-ve. Praktika: 1) OSHC nga fusha të ndryshme me interes marrin pjesë rregullisht në të gjitha fazat e zbatimit strategjik të zhvillimit të dokumentit, dhe vlerësimin. 2) Ka shumë shembuj që tregojnë se bashkëpunimi mes shtetit dhe OShC-ve dhe zhvillimi i shoqërisë civile është përmirësuar dhe zbatohet në përputhje me ose përtej masave të parashikuara në dokumentin strategjik. 3) Zbatimi i dokumentit strategjik është monitoruar, vlerësuar dhe rishikuar periodikisht. 4) Politikat shtetërore për bashkëpunim midis shtetit dhe OShC-ve dhe për zhvillimin e shoqërisë civile janë të bazuara në të dhënat e besueshme të mbledhura nga statistikat kombëtare duke marrë parasysh larminë e sektorit. | Bertelsmann Stiftung's Transformation Index (http://www.bti-project.org/country-reports/pse/blr/) EU Progress Report (http://ec.europa.eu/enlargement/how-does-it-work/progress-reports/index_en.htm) Sustainable Governance Indicators (http://www.sgi-network.org/index.php) *Status Index and Management Index |
| | 2. Shteti njih, përmes veprimit të institucioneve të tij, rëndësinë e zhvillimit të sektorit dhe bashkëpunimit me të | Legjislacioni: 1) Ekziston një institucion në nivel kombëtar ose mekanizëm me një mandat për të lehtësuar bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile (p.sh., Njësia / Zyra për bashkëpunim; pikat e kontaktit në ministri, këshill). 2) Ka dispozita të detyrueshme për përfshirjen e OShC-ve në vendimet e marra nga institucioni kompetent apo mekanizmi (at). Praktika: 1) Institucioni i nivelit kombëtar apo mekanizmi (at) ka burime të mjaftueshme dhe mandat për lehtësimin e dialogut OShC-qeveri, për të diskutuar sfidat dhe propozuar politikat kryesore për zhvillimin e shoqërisë civile. 2) OSHCtë konsultohen rregullisht dhe përfshihen në proceset dhe vendimet e institucionit kompetent ose mekanizmit (ave). | |

| PARIMI | STANDARTET/ HAPAT E MATJES SE PROGRESIT | INDIKATORËT | INDEKSE RELEVANTE GLOBALE APO RAJONALE |
|--|---|---|---|
| Nën-fusha 3.2: Përfshirja në proceset e hartimit të politikave dhe vendim-marrjes | | | |
| OSHC-të janë të përfshira në mënyrë efektive në procesin e hartimit të politikave dhe vendim-marrje | 1. Ekzistojnë standarte që mundësojnë përfshirjen e OSHC-ve në vendim-marrje, të cilat lejojnë kontributin e OSHC-ve në kohën e duhur. | <p>Legjislacioni:</p> <p>1) Ekzistojnë standarte të përcaktuara qartë për përfshirjen e OSHC-ve në proceset vendimmarrëse dhe të hartimit të politikave në përputhje me praktikën më të mira rregullatore që përshkruajnë kërkesat minimale që çdo proces politikë-bërës duhet të përmbushë.</p> <p>2) Politikat shtetërore parashikojnë programet edukative / trajnime për nëpunësit civilë në përfshirjen e OSHC-ve në punën e institucioneve publike.</p> <p>3) Rregulloret e brendshme kërkojnë që njësi të specifikuar ose zyrtarë në qeveri, ministritë e linjës apo agjenci të tjera qeveritare të koordinojnë, monitorojnë dhe raportojnë përfshirjen e OSHC-ve në punën e tyre.</p> <p>Praktika:</p> <p>1) Institucionet publike në mënyrë rutinore ftojnë të gjitha OSHC-të e interesuara për të komentuar mbi politika / iniciativa ligjore në një fazë të hershme.</p> <p>2) OSHC-ve u ofrohet informacion adekuat për përmbajtjen e draft dokumenteve dhe detajet e konsultimeve me kohë të mjaftueshme për t'u përgjigjur.</p> <p>3) Institucionet publike bëjnë publike informacione të shkruara mbi rezultatet e konsultimeve, duke përfshirë arsyet përse disa rekomandime nuk janë përfshirë.</p> <p>4) Shumica e nëpunësve civilë të ngarkuar me hartimin e politikave publike kanë përfunduar me sukses programet e nevojshme arsimore / trajnuese.</p> <p>5) Shumica e njësive / zyrtarëve që merren me koordinimin dhe monitorimin e konsultimeve publike janë funksionale dhe kanë kapacitet të mjaftueshëm.</p> | <p>NGO Sustainability Index for Central and Eastern Europe and Euroasia, USAID (http://transition.usaid.gov/location/europe_eurasia/dem_gov/ngoindex/)</p> <p>ICNL's NGO Law Monitor (http://www.icnl.org/research/monitor/index.html)</p> <p>Worldwide Governance Indicators (http://info.worldbank.org/governance/wgi/index.asp)</p> <p>Civic Engagement Index (http://www.oecdbetterlifeindex.org/topics/civic-engagement/)</p> <p>Bertelsmann Stiftung's Transformation Index (http://www.bti-project.org/country-reports/pse/blr/)</p> |
| | 2. Të gjitha draft politikat dhe ligjet janë lehtësisht të qasshme për publikun në kohën e duhur | <p>Legjislacioni:</p> <p>1) Legjislacioni ekzistues detyron institucionet shtetërore për të bërë publike të gjitha projektligjet dhe ligjet e politikave të miratuara, dhe përjashtimet janë përcaktuar qartë dhe në përputhje me normat ndërkombëtare dhe praktikën më të mira.</p> <p>2) Ekzistojnë mekanizma dhe procedura të qarta për qasje në informacione / dokumenta me karakter publik.</p> <p>3) Ekzistojnë sanksione të përshkruara qartë për nëpunësit civilë / njësitë për shkeljen e kërkesave ligjore për qasje në informacione me karakter publik.</p> <p>Praktika:</p> <p>1) Institucionet publike në mënyrë aktive publikojnë projektligje dhe ligje e politika të miratuara, vetëm nëse ato i nënshtrohen përjashtimeve të përcaktuara me ligj.</p> <p>2) Institucionet publike u përgjigjen shumicës së kërkesave për qasje në informacionin publik brenda afatit të përcaktuar me ligj, në një format të qartë, japin shpjegime me shkrim mbi arsyet e refuzimit, dhe evidentojnë të drejtën e apelit dhe procedura për apelim.</p> <p>3) Rastet e shkeljeve të ligjit sanksionohen.</p> | |
| | 3. Përfaqësuesit e OSHC-ve janë partnerë të barabartë në diskutimet në organet ndër-sektoriale dhe janë zgjedhur nëpërmjet kritereve dhe proceseve të përcaktuara qartë | <p>Legjislacioni:</p> <p>1) Legjislacioni ekzistues kërkon që institucionet publike të ftojnë përfaqësuesit e OSHC-ve në organe të ndryshme të vendim-marrjes dhe / ose këshillimore të krijuara nga institucionet publike.</p> <p>2) Ka udhëzime të qarta se si të sigurohet përfaqësimi i duhur nga shoqëria civile, bazuar në kritere transparente dhe të paracaktuara.</p> <p>Praktika:</p> <p>1) Organet vendim-marrëse dhe këshillimore për çështjet dhe politikat që lidhen me shoqërinë civile në përgjithësi përfshijnë përfaqësuesit e OSHC-ve.</p> <p>2) Përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile në këto organe kanë mundësi të paraqesin lirisht dhe të mbrojnë pozicionet e tyre, pa u sanksionuar.</p> | |

| PARIMI | STANDARTET/ HAPAT E MATJES SE PROGRESIT | INDIKATORËT | INDEKSE RELEVANTE GLOBALE APO RAJONALE |
|---|--|---|---|
| | | 3) Përfaqësuesit e OshC-ve janë përzgjedhur përmes proceseve të drejta dhe transparente seleksionimi. 4) Pjesëmarrja në këto organe nuk i ndalon OSHC të përdorin mënyra alternative të advokacisë ose promovimin e qëndrimeve alternative të cilat nuk janë në përputhje me pozicionin e organit përkatës. | |
| Nën-fusha 3.3: Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve | | | |
| Ekziston një mjedis mbështetës për përfshirjen e OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve | 1. OSHC-të janë të angazhuara në shërbime të ndryshme dhe të konkurrojnë për kontrata shtetërore mbi baza të barabartë me ofruesit e tjerë | Legjislacioni: 1) Legjislacioni ekzistues lejon OSHC-të të ofrojnë shërbime në fusha të ndryshme si arsimi, shëndetësia, shërbimet sociale. 2) OSHCnuk kanë pengesa për të ofruar shërbime që nuk janë të përcaktuara me ligj (shërbime "shtesë"). 3) Legjislacioni ekzistues nuk rëndon me kërkesa shtesë për OSHC-të, kërkesa që nuk ekzistojnë për ofruesit e tjerë të shërbimeve. Praktika: 1) OSHCjanë në gjendje të përfitojnë kontrata në kompeticion me ofruesit e tjerë dhe janë të angazhuar në shërbime të ndryshme (p.sh. në fushën e arsimit, shëndetit, kërkimit dhe trajnimit). 2) OSHCjanë të përfshira në të gjitha fazat e zhvillimit dhe ofrimit të shërbimeve (vlerësimin e nevojave, përcaktimin e shërbimeve që adresojnë më mirë nevojat, në monitorim dhe vlerësim). 3) Në rastet kur kërkohet regjistrim / licencim, procedura për marrjen e licensës nuk është tepër e vështirë. | NGO Sustainability Index for Central and Eastern Europe and Euroasia, USAID (http://transition.usaid.gov/locations/europe_eurasia/dem_gov/ngoin dex/) Human Development Index (http://hdr.undp.org/en/statistics/hdi/) Global Giving Index (https://www.cafonline.org/publications/2011-publications/world-giving-index-2011.aspx) |
| | 2. Shteti është angazhuar për financimin e shërbimeve dhe financimi është i parashikueshëm dhe i ofruar për një periudhë afat-gjatë | Legjislacioni: 1) Buxheti parashikon fonde për lloje të ndryshme shërbimesh të cilat mund të ofrohen nga OSHC-të, duke përfshirë këtu edhe financime disa-vjeçare. 2) Nuk ka pengesa ligjore për OSHC-të që të përfitojnë fonde publike për ofrimin e shërbimeve të ndryshme (qoftë përmes prokurimit ose nëpërmjet një forme tjetër kontraktimi apo mekanizmi të ofrimit të granteve). 3) OSHC-të mund të nënshkruajnë kontrata afatgjatë për ofrimin e shërbimeve. Praktika: 1) OSHC-të janë përfitues të fondeve për shërbime. 2) OSHC-të marrin fonde të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet bazë të shërbimeve të cilat janë kontraktuar të ofrojnë, duke përfshirë kosto proporcionale institucionale (kosto manaxhimi). 3) Nuk ka vonesa në pagesa dhe financimi është fleksibël me qëllim ofrimin e shërbimeve sa më cilësore. | |
| | 3. Shteti ka përcaktuar procedura të qarta për kontraktimin e shërbimeve të cilat lejojnë për zgjedhjen transparente të ofruesve të shërbimeve, duke përfshirë edhe OSHC-të | Legjislacioni: 1) Ekziston një procedurë e qartë dhe transparente përmes të cilës financimi për shërbime është i shpërndarë ndërmjet ofruesve. 2) Çmimi nuk është kriter kryesor për zgjedhjen e ofruesit të shërbimit dhe vlera më e mirë përcaktohet si nga cilësia e shërbimit ashtu edhe një vlerësim financiar i konkurrentit. 3) Ka udhëzime të qarta se si të sigurohet transparenca dhe të shmangët konflikti i interesave. 4) Ekziston e drejta për të të apeluar kundër rezultateve të kompeticionit. Praktika: 1) Shumë shërbime u janë kontraktuar OSHC-ve. 2) Kompeticionet konsiderohen të drejta dhe janë shmangur konfliktet e interesit. 3) Zyrtarët shtetërorë kanë kapacitet të mjaftueshëm për | |

| PARIMI | STANDARTET/ HAPAT E MATJES SE PROGRESIT | INDIKATORËT | INDEKSE RELEVANTE GLOBALE APO RAJONALE |
|--|---|---|---|
| Ekziston një mjedis mbështetës për përfshirjen e OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve | | të organizuar procedurat. | |
| | 4. Ekziston një sistem i qartë i llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit të ofrimit të shërbimeve | <p>Legjislacioni:</p> <p>1) Ekziston mundësia ligjore për monitorimin si të shpenzimeve ashtu edhe të cilësisë së ofruesve të shërbimeve.</p> <p>2) Ekzistojnë standarde të qarta të cilësisë dhe procedura të monitorimit për shërbimet.</p> <p>Praktika:</p> <p>1) OSHCnuk janë subjekt i kontrollit të tepruar.</p> <p>2) Monitorimi kryet mbi një baza të rregullta, sipas procedurave dhe kritereve të paranoftuara..</p> <p>3) Kryhet vlerësim i rregullt i cilësisë dhe efekteve / impaktit të shërbimeve të ofruara dhe ky vlerësim është në dispozicion të publikut.</p> | |

Referencat

Fusha 1: Garancitë Themelore Juridike të Lirive

Charter of Fundamental Rights of the European Union, (2000/C 364/01), 2000

Council of Europe (CoE) Recommendation CM/Rec (2007)14 of the Committee of Ministers of the Council of Europe to member states on the legal status of non-governmental organisations in Europe
<https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1194609&Site=CM&BackColorInternet=9999CC&BackColorIntranet=FFBB55&BackColorLogged=FFAC75>

Council of Europe (CoE) Recommendation CM/Rec(2007)14 of the Committee of Ministers to member states on the legal status of non-governmental organisations in Europe
<https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1194609>

Defending Civil Society Report, 2nd edition, 2012, International Center for Not-for-Profit Law and World Movement for Democracy Secretariat at the National Endowment for Democracy (NED)
http://www.icnl.org/research/resources/dcs/DCS_Report_Second_Edition_English.pdf

Defending Civil Society Toolkit: Tips for Engaging in NGO Law Reforms, International Center for Not-for-Profit Law and World Movement for Democracy Secretariat at the National Endowment for Democracy (NED)
<http://prod.defendingcivilsociety.org/en/index.php/home>

European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms –ECHR
<http://conventions.coe.int/Treaty/en/Summaries/Html/005.htm>

European Court of Human Rights Case Law
<http://www.echr.coe.int/ECHR/EN/Header/CaseLaw/Decisions+and+judgments/HUDOC+database/>

European Parliament resolution of 11 December 2012 on a Digital Freedom Strategy in EU Foreign Policy (2012/2094(INI))
<http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?type=TA&language=EN&reference=P7-TA-2012-470>

ILO Declaration on Fundamental Principles and Rights at Work
http://www.ilo.org/dyn/declaris/DECLARATIONWEB.static_jump?var_language=EN&var_pagename=DECLARATIONTEXT

International Covenant for Civil and Political Rights – ICCPR
<http://www.ohchr.org/english/law/ccpr.htm>

International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights
<http://www2.ohchr.org/english/law/cescr.htm>

International Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination
<http://www2.ohchr.org/english/law/cerd.htm>

OSCE/ODIHR Key Guiding Principles of Freedom of Association with an Emphasis on Non-Governmental Organizations
<http://www.legislationline.org/upload/lawreviews/46/a8/24ea8fac61f2ba6514e5d38af6b2.pdf>

OSCE/ODIHR, 2007, Guidelines on Freedom of Peaceful Assembly
<http://www.osce.org/odihr/24523>

OSCE/ODIHR, 2010, Guidelines on Freedom of Peaceful Assembly. Office for Democratic Institutions and Human Rights and the Venice Commission
<http://www.osce.org/odihr/73405?download=true>

OSCE/ODIHR – Venice Commission, 2010, Guidelines on Freedom of Peaceful Assembly (2nd edition)
<http://www.venice.coe.int/docs/2010/CDL-AD%282010%29020-e.pdf>

The Johannesburg Principles on National Security, Freedom of Expression and Access to Information
<http://www.article19.org/data/files/pdfs/standards/joburgprinciples.pdf>

United Nations (UN) Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women
<http://www2.ohchr.org/english/law/cedaw.htm>

UN Convention on the Rights of the Child
<http://www2.ohchr.org/english/law/crc.htm>

UN Convention on the Rights of Persons with Disabilities
http://untreaty.un.org/English/notpubl/IV_15_english.pdf

Universal Declaration of Human Rights
<http://www.ohchr.org/english/about/publications/docs/fs2.htm>

UN Declaration on the Right and Responsibility of Individuals, Groups and Organs of Society to Promote and Protect Universally Recognized Human Rights and Fundamental Freedoms, adopted by General Assembly in Resolution 53/144 of 9 December 1998.
<http://www2.ohchr.org/english/law/freedom.htm>

UN, Economic and Social Council, U.N. Sub-Commission on Prevention of Discrimination and Protection of Minorities, Siracusa Principles on the Limitation and Derogation of Provisions in the International Covenant on Civil and Political Rights, Annex, UN Doc E/CN.4/1985/4 (1984)
<http://www.unhcr.org/refworld/pdfid/4672bc122.pdf>

UN First Optional Protocol to the International Covenant on Civil and Political Rights
<http://www2.ohchr.org/english/law/ccpr.htm>

UN Human Rights Council, Resolution 12/16, Freedom of opinion and expression, 12 October 2009
<http://daccess-dds-ny.un.org/doc/RESOLUTION/LTD/G09/161/50/PDF/G0916150.pdf?OpenElement>

UN Human Rights Council Resolution 15/21 on the Rights to Freedom of Peaceful Assembly and Association, 6 October 2010
<http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/LTD/G10/164/82/PDF/G1016482.pdf?OpenElement>
Balkan Civic Practices # 9 71

UN Human Rights Council Resolution 15/21 on the Rights to Freedom of Peaceful Assembly and of Association, 12 October 2012
<http://daccess-dds-ny.un.org/doc/RESOLUTION/GEN/G12/174/63/PDF/G1217463.pdf?OpenElement>

UN Human Rights Council Resolution on The promotion, protection and enjoyment of human rights on the Internet, A/HRC/20/L.13, 29 June 2012,

<http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/LTD/G12/146/89/PDF/G1214689.pdf?OpenElement>

Report of the Special Rapporteur on the rights to freedom of peaceful assembly and of association, Maina Kiai, June 2012

http://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/HRCouncil/RegularSession/Session20/A-HRC-20-27_en.pdf

Report of the United Nations High Commissioner for Human Rights, Effective measures and best practices to ensure the promotion and protection of human rights in the context of peaceful protests, 2013, A/HRC/22/28,

<http://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/HRCouncil/RegularSession/Session22/A.HRC.22.28.pdf>

US State Department, The Guiding Principles on Non-Governmental Organizations (issued on December 14, 2006)

http://www.icnl.org/research/journal/vol9iss1/art_9.htm

Fusha 2: Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OJF-të

Council of Europe (CoE) Recommendation CM/Rec (2007)14 of the Committee of Ministers of the Council of Europe to member states on the legal status of non-governmental organisations in Europe <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1194609&Site=CM&BackColorInternet=9999CC&BackColorIntranet=FFBB55&BackColorLogged=FFAC75>

Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, The roots of democracy and sustainable development: Europe's engagement with Civil Society in external relations, European Commission, Brussels, 12.9.2012, COM(2012) 492

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2012:0492:FIN:EN:PDF>

Defending Civil Society Report, 2nd edition, 2012, International Center for Not-for-Profit Law and World Movement for Democracy Secretariat at the National Endowment for Democracy (NED)

http://www.icnl.org/research/resources/dcs/DCS_Report_Second_Edition_English.pdf

Fusha 3: Marrëdhënia Qeveri -OSHC

Consolidated Version of the Treaty on European Union, article 10 and 11

<http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:C:2010:083:0013:0046:EN:PDF>

Council of Europe (CoE), Code of Good Practice for Civil Participation in the Decision-Making Process, adopted by the Conference of INGOs, 2009

<https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1514961>

Council of Europe (CoE), Declaration by the Committee of Ministers on the Code of Good Practice for Civil Participation in the Decision-Making Process, 2009

<https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1525009&Site=CM>

Council of Europe (CoE), Recommendation CM/Rec(2010)5 of the Committee of Ministers to member states on measures to combat discrimination on grounds of sexual orientation or gender identity.

<https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1606669>

Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, The roots of democracy and sustainable development: Europe's engagement with Civil, Society in external relations, European Commission, Brussels, 12.9.2012, COM(2012) 492

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2012:0492:FIN:EN:PDF>

European Commission, White Paper on European Governance, COM(2001) 428

http://ec.europa.eu/governance/white_paper/en.pdf

European Commission Communication, Towards a Reinforced Culture of Consultation and Dialogue – General principles and minimum standards for consultation of interested parties by the Commission, COM (2002) 704.

http://ec.europa.eu/governance/docs/comm_standards_en.pdf

ECNL Social Contracting Handbook

<http://www.ecnl.org.hu/index.php?part=13publications&pubid=30>

European Parliament Resolution Developing Civil Dialogue under the Treaty of Lisbon, P6_TA(2009)0007, 13 January 2009

<http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//TEXT+TA+P6-TA-2009-0007+0+DOC+XML+V0//EN>

OECD, Citizens as Partners: Information, Consultation and Active Participation in Policy- Making, 2001

http://www.ecnl.org/dindocuments/214_OECD_Engaging%20Citizens%20in%20Policy-Making.pdf

World Bank, A Call for Participatory Decision-Making: Discussion Paper on World Bank-Civil Society Engagement, 2005

http://siteresources.worldbank.org/CSO/Resources/World_Bank_Civil_Society_Discussion_Paper_FINAL_VERSION.pdf



Partnerët Shqipëri
Qendra për Ndryshim
dhe Manaxhim Konflikti